



Strasbourg, 10 December 2008

ACFC(2008)001  
/Albanian language version/

---

**APORT I PROGRESIT I DORËZUAR NGA ADMINISTRATA E  
PËRKOHSHME E MISIONIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA  
NË KOSOVË MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË  
KËSHILLIT TË EVROPËS PËR KONVENTËN KORNIZË MBI  
MBROJTJEN E PAKICAVE KOMBËTARE NË KOSOVË**

---

Duke vepruar në përputhje me Marrëveshjen në mes të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në **Kosovë (UNMIK)** dhe Këshillit të Evropës për rregullimet teknike lidhur me Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKPK), të nënshkruar më 30 qershor 2004;

Duke iu përgjigjur shkresës nga Komiteti Këshillëdhënës mbi KKPK-në, duke vepruar në përputhje me nenin 2.3 të marrëveshjes së sipërpërmendur, drejtuar Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), më datë 13 korrik 2007, duke kërkuar informacione mbi progresin e implementimit të KKPK në Kosovë, pas miratimit të Rezolutës 2006/9 nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, më 21 qershor 2006 për implementimin e KKPK në Kosovë;

Prandaj, Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) përgatiti Projektraportin e Progresit bazuar në reagimet e zyrave të UNMIK-ut dhe të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), i rishqyrtuar dhe i ripunuar nga Zyra e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm;

UNMIK-u parqet Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve në Rezolutën e Këshillit të Evropës 2006/9.

## PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE .....	5
HYRJE .....	7
<i>Të përgjithshme</i> .....	8
Rekomandimi nr. 1 i Këshillit të Evropës .....	8
Rekomandimi nr. 2 i Këshillit të Evropës.....	9
<i>Grumbullimi i të dhënave</i> .....	10
Rekomandimi nr. 3 i Këshillit të Evropës.....	10
Rekomandimi nr. 4 i Këshillit të Evropës.....	12
Rekomandimi nr. 5 i Këshillit të Evropës.....	13
<i>Mjetet juridike dhe zbatimi i ligjit</i> .....	13
Rekomandimi nr. 6 i Këshillit të Evropës.....	13
Rekomandimi nr. 7 i Këshillit të Evropës .....	14
Rekomandimi nr. 8 i Këshillit të Evropës.....	16
<i>Procesi i kthimit dhe shqetësimet për sigurinë</i> .....	16
Rekomandimi nr. 9 i Këshillit të Evropës .....	16
Rekomandimi nr. 10 i Këshillit të Evropës .....	20
Rekomandimi nr. 11 i Këshillit të Evropës .....	21
Rekomandimi nr. 12 i Këshillit të Evropës .....	22
<i>Kulturat e pakicave dhe çështjet e medieve</i> .....	23
Rekomandimi nr. 13 i Këshillit të Evropës .....	23
Rekomandimi nr. 14 i Këshillit të Evropës .....	26
Rekomandimi nr. 15 i Këshillit të Evropës .....	26
<i>Përdorimi i gjuhëve</i> .....	28
Rekomandimi nr. 16 i Këshillit të Evropës .....	28
Rekomandimi nr. 17 i Këshillit të Evropës .....	30
Rekomandimi nr. 18 i Këshillit të Evropës .....	34
<i>Edukimi</i> .....	38
Rekomandimi nr. 19 i Këshillit të Evropës .....	38
Rekomandimi nr. 20 i Këshillit të Evropës .....	39
Rekomandimi nr. 21 i Këshillit të Evropës .....	41
Rekomandimi nr. 22 i Këshillit të Evropës .....	42
Rekomandimi nr. 23 i Këshillit të Evropës .....	42
Rekomandimi nr. 24 i Këshillit të Evropës .....	43

<i>Pjesëmarrja</i> .....	44
Rekomandimi nr. 25 i Këshillit të Evropës .....	44
Rekomandimi nr. 26 i Këshillit të Evropës .....	44
Rekomandimi nr. 27 i Këshillit të Evropës .....	44
Rekomandimi nr. 28 i Këshillit të Evropës .....	45
Rekomandimi nr. 29 i Këshillit të Evropës .....	45
<i>Mbrojtja kundër ndryshimeve të popullatës</i> .....	46
Rekomandimi nr. 30 i Këshillit të Evropës .....	46
Rekomandimi nr. 31 i Këshillit të Evropës .....	46
<i>Kontaktet tej kufitare</i> .....	46
Rekomandimi nr. 32 i Këshillit të Evropës .....	46
SHTOJCA I.....	47
SHTOJCA II.....	48
SHTOJCA III.....	50

## LISTA E SHKURTESAVE

UA	Udhëzim Administrativ
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
AKQM	Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë
KiK	Kuvendi i Kosovës
KK	Komiteti i Komuniteteve
NJQMGJ	Njësia Qendrore për Monitorimin e Gjuhëve
NJMPGJZIJK	Njësia për Monitorimin e Përdorimit të Gjuhëve Zyrtare në Institucionet Qendrore në Kosovë
KE	Kryeshefi Ekzekutiv
Korniza Kushtetuese	Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë
KDIK	Komiteti për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve
DÇC	Departamenti i Çështjeve Civile
KEDNJ	Konventa Evropiane mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale
KEGJRM	Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale apo Minoritare
KKPK	Konventa Kornizë për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
KAÇBP	Komisioni i Ankesave për Çështje Banesore Pronësore
DÇBP	Drejtoria për Çështje Banesore Pronësore
NJDNJ	Njësia për të Drejtat e Njeriut
ZCN	Zyra Civile Ndërkombëtare
PNDPCP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
PZHVBV	Personat e Zhvendosur Brenda Vendit
KPM	Komisioneri i Pavarur i Mediave
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
PKIS	Plani i Kosovës për Implementimin e Standardeve
PDTK	Partia Demokratike Turke e Kosovës
LPA	Ligji mbi Procedurën Administrative
LTK	Ligji mbi Trashëgiminë Kulturore
Ligji mbi Edukimin	Ligji mbi Edukimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë
LTHZSM	Ligji për Themelimin e Zonave Speciale Mbrojtëse
DLEP	Draft Ligji për Emrin Personal
Ligji mbi Gjuhët	Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente
MEM	Ministria e Energjetikës dhe Minierave
MAPH	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MTPT	Ministria e Transportit Postës dhe Telekomunikacionit
MSHP	Ministria e Shërbimeve Publike
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
IOK	Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë
ZKM	Zyra e Kryeministrit
OSBE	Misioni i OSBE-së në Kosovë
KAP	Komisioni i Ankesave Pronësore
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë
NJKP	Njësia Komunale Pilot
SP	Sekretar i Përhershëm
KIR	Komisioni për Zbatimin e Rindërtimit
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SPPPGJZ	Spektori për Përfshirjen e Pakicave dhe Përdorimi i Gjuhëve Zyrtare
ZSK	Zyra Statistike e Kosovës
ZSM	Zona Speciale Mbrojtëse
PSKB	Përfaqësuesi Special i Kombeve të Bashkuara
SP	Sekretari i Përgjithshëm
NP	Nëngrup Punues
KPM	Komisioni i Përkohshëm për Media
UM	Universiteti i Mitrovicës
UP	Universiteti i Prishtinës
PKBZH	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

## HYRJE

Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) përshëndet këtë mundësi për të raportuar për progresin mbi implementimin e rekomandimeve të përfshira në Rezolutën 2006/9 të Këshillit të Evropës. Me këtë raport, UNMIK-u dëshiron të paraqesë progresin në zhvillimin e politikave dhe legjislacionit, që synojnë parandalimin e diskriminimit etnik dhe promovimin e pajtimit të komuniteteve dhe kohezionin e tyre, si dhe garancitë për ruajtjen e gjuhëve të pakicave dhe sigurimin e edukimit të tyre.

UNMIK dhe Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) me vendosmëri janë të përkushtuar që të veprojnë në përputhje të plotë me parimet e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKPK) dhe të eliminojnë të gjitha format e mostolerancës dhe diskriminimit etnik, me qëllim të ndërtimit të një shoqërie të bashkuar kosovare. Ne aspirojmë ta arrijmë këtë për çdo individ, pavarësisht nga prejardhja etnike, dhe ekziston mundësia që të shfrytëzohet potenciali i tij përmes gëzimit të të drejtave të barabarta, mundësive në jetë dhe përgjegjësi.

Që nga miratimi i Rezolutës 2006/9 nga Komiteti i Ministrave, është bërë përparim edhe më i madh. Në gusht të vitit 2006, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) e shpalli Ligjin e Kuvendit të Kosovës mbi lirinë e fesë, i cili parasheh neutralitetin religjioz në Kosovë dhe mbron autonominë e grumbullimeve religjioze, veçanërisht të Kishës Ortodokse Serbe.

Në shtator të vitit 2006, IPVQ-të me mbështetjen dhe pjesëmarrjen e palëve të interesuara ndërkombëtare dhe vendore, filluan hartimin e një Strategjie qeveritare për integrimin e personave që u përkasin komunitetit rom, ashkanli dhe egjiptian. Përfaqësuesit nga secili komunitet, Zyra e Kryeministrit (ZKM), Instituti Kosovar për Shoqëri të Hapur dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) të gjithë janë partnerë të barabartë në zhvillimin e strategjisë.

Në tetor të vitit 2006, PSSP-ja shpalli Ligjin mbi përdorimin e gjuhëve, Rregullorja e UNMIK-ut 2006/52, sipas të cilës autoritetet komunale dhe qendrore duhet të mbrojnë dhe ruajnë të gjitha objektet e trashëgimisë kulturore me vlerë historike dhe kulturore. Me të njëjtin Ligj po ashtu krijohet një Këshill kosovar për trashëgiminë kulturore, i cili do të marrë vendime se cilat objekte kulturore do të jenë nën mbrojtjen e institucioneve të Kosovës.

Në maj të vitit 2007, Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë (ZKQM) e cila vepron në kuadër të ZKM, themeloi një grup të punës, i përbërë nga përfaqësues nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) dhe nga OSBE-ja, për të identifikuar masat për implementimin e KKPK në Kosovë.

Në qershor të vitit 2007, ZKM, së bashku me OSBE-në, e publikuan raportin <sup>1</sup> mbi implementimin e Ligjit kundër diskriminimit në Kosovë. Raporti identifikon dhe

---

<sup>1</sup> Implementimi i Ligjit kundër diskriminimit; Një sfidë për Kosovën, qershor 2007.

propozon masa të ndryshme të cilat do të ndihmojnë në implementimin e Ligjit kundër diskriminimit, dhe bën përpjekje për arritjen e cilësisë dhe krijimit të një komuniteti të bashkuar.

Në tetor të vitit 2007, IPVQ-të ishin afër për të përmbyllur një listë të pikave të veprimit për të promovuar pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë në shërbimin civil dhe për të ngritur vetëdijesimin e KKPK brenda ministrive të IPVQ-ve.

Kjo përbën një pjesë të përgjigjes së shqyrtimit nga IPVQ-të të rekomandimeve të Këshillit të Evropës mbi KKPK.

### ***Të përgjithshme***

Rekomandimi nr. 1 i Këshillit të Evropës. ***Të sigurohet se ka qartësi të mjaftueshme lidhur me përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë për implementimin e neneve të ndryshme në Konventën Kornizë dhe që t'u mos delegohen kompetenca institucioneve vendore në sektorët relevant para kohe.***

IPVQ-të, me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare, janë dedikuar të ekzekutojnë përgjegjësitë transferuara nga UNMIK-u me qëllim të ndërtimit dhe ruajtjes së institucioneve përfaqësuese në Kosovë. Të udhëhequr nga parimet ndërkombëtare për mbrojtjen e pakicave, ku përfshihet mosdiskriminimi, barazia dhe pjesëmarrja e plotë në shoqëri, IPVQ-të i kanë veglat në duart e tyre për krijimin e strukturave të qëndrueshme për mbështetjen e komuniteteve pakicë dhe një shoqërie funksionale multi-etnike në Kosovë. Prandaj, theksi për sigurimin e të drejtave për të gjitha komunitetet është prioritet për IPVQ-të.

Gjatë viteve të fundit, institucionet e Kosovës kanë fituar përvojë në implementimin e një vargu të gjerë të legjislacionit dhe programeve, të reflektuara në vlerësimin e performancës së IPVQ-ve në Planin për implementimin e standardeve për Kosovën. Miratimi i legjislacionit aktual në fushën e përdorimit të gjuhëve, ai kundër diskriminimit, liria e fesë, zhvillimet jolegjislative, siç është kthimi në Mëhallën e romëve në jug të Mitrovicës, bartja e përgjegjësisë në sektorin e policisë dhe të drejtësisë, dhe progresi i vazhdueshëm në rindërtimin e objekteve të dëmtuara religjioze dhe kulturore, të gjitha demonstrojnë se IPVQ-të janë të afta për t'u angazhuar në identifikimin e strukturave dhe në miratimin e masave mbështetëse për komunitetet pakicë. Në anën tjetër, pranohet se kërkojnë përpjekje edhe më të mëdha për përmirësimin e gjendjes së komuniteteve pakicë dhe për të bërë integrimin e tyre në mënyrë efektive. Për Kosovën, kthimi i pakicave, pajtimi i komuniteteve, edukimi, rritja e besimit të komuniteteve pakicë në gjyqësi dhe papunësia janë fusha të shqetësimit që përfshijnë të gjitha komunitetet. Këto shqetësime trajtohen në mënyrë efektive duke rritur kapacitetin e IPVQ-ve për t'u angazhuar në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe për të ndërtuar një shoqëri tolerante dhe multi-etnike.

Në maj të vitit 2007, Zyra këshillëdhënëse për qeverisje të mirë, Zyra e Kryeministrit (ZKQM/ZKM), duke iu përgjigjur rekomandimeve të Komitetit të Ministrave të



Këshillit të Evropës mbi KKPK, themeloi një grup punues për implementimin e KKPK, me detyrë për t'u shpërndarë rekomandimet ministrive të IPVQ-së dhe për të identifikuar strukturat dhe mjetet e kërkuara për të siguruar implementim efektiv. Në qershor të vitit 2007, kryesuesi i grupit punues, ZKQM/ZKM, së bashku me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK), iniciuan një projekt për implementimin e rekomandimeve të KKPK. Projekti kishte dy objektiva: të qartësojë përgjegjësitë e ministrive individuale sipas KKPK dhe të identifikojë objektivat dhe veprimet konkrete të cilat duhet miratuar nga ministrinë për implementimin e rekomandimeve.

Për t'i arritur këto dy objektiva, ZKQM/ZKM organizoi punëtori me të gjitha njësitë për të drejtat e njeriut<sup>2</sup> (NJDNJ) për të identifikuar rekomandimet dhe për të identifikuar ata që janë relevante për ministrinë e tyre përkatëse. Në këto punëtori kanë marrë pjesë ZKQM/ZKM, MKK, një ekspert nga Sekretariati i KKPK, OSBE-ja, e cila u mbajt në qershor të vitit 2007. Në punëtori është konsultuar çdo NJDNJ për të identifikuar objektivat dhe për të propozuar masat për implementimin e KKPK, brenda çdo ministrie, së bashku me pjesëmarrësit e grupit punues. Pas përfundimit të punëtorisë, u organizua një sërë e takimeve plenare me grupin punues dhe me koordinatorët e NJDNJ në ministrinë, me qëllim të përmbledhjes së përvojave të punëtorisë, ofrimin e rekomandimeve të përgjithshme dhe identifikimin e pikave të veprimit për të gjitha ministrinë e IPVQ-ve. Rezultatet e këtyre punëtorive janë përpiluar në matrica, nga një për çdo ministri, të cilat përbëjnë veprimet e propozuara të cilat do të sigurojnë përputhshmërinë e të gjitha ministrive sipas KKPK.

Faza e dytë filloi në fillim të vjeshtës së vitit 2007 dhe përfshinte kthimin e NJDNJ tek ministrinë përkatëse për të diskutuar masat e propozuara në matrica dhe për të pranuar komente dhe përkushtimin nga çdo ministri se do të miratojnë veprimet dhe objektivat e identifikuar. Për ta siguruar këtë, matricat u janë dërguar të gjithë sekretarëve të përhershëm. Versioni i fundit i matricës së përgjithshme pritet që të kompletohet gjatë vjeshtës së vitit 2007 dhe do të jetë rezultat i konsensusit brenda çdo ministrie, në pajtim me mandatin dhe përgjegjësitë e departamenteve të tyre.

Pas përfundimit të fazës së dytë në vjeshtë, u organizua një konferencë për të diskutuar matricat me Këshillin e Evropës dhe me organizatat joqeveritare, të cilat paraqesin komunitetet pakicë që jetojnë në Kosovë. Kjo konferencë u zhvillua ndërmjet 11 dhe 12 tetorit 2007. Një dokument përfundimtar i cili përfshinte të gjitha objektivat e identifikuar dhe pikat e veprimit do t'i dërgohet Qeverisë për miratim, me pajtimin e çdo ministrie.

***Rekomandimi nr. 2 i Këshillit të Evropës të përmirësohet vetëdijesimi brenda organeve relevante, ndërkombëtare dhe vendore, për parimet e përfshira në nenin 15 dhe në nenet tjera të Konventës Kornizë, me qëllim të sigurimit të zbatimit të tyre.***

---

<sup>2</sup> Njësitë e të drejtave të njeriut aktualisht po themelohen në çdo ministri të IPVQ-ve, në pajtim me Udhëzimin administrativ të ZKM nr. 2005/8 për termat e referencës për njësitë e të drejtave të njeriut.

Projekti i ZKQM/ZKM ku përfshihen NDNJ për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Evropës mbi KKKPK, parasheh ngritjen e vetëdijësimit dhe krijimin e kapaciteteve të ministrive të IPVQ-ve si njërin prej objektivave kryesore. Një numër i ministrive të cilat janë përkushtuar të krijojnë mekanizma specifikë për këtë qëllim siç janë grupet e punës ndër-departamentet për pikat referuese, funksioni i të cilave është sigurimi i mbështetjes së parimeve të KKKPK në zhvillimin, zbatimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e politikave të qeverisë, në programet dhe në procedurat e brendshme të punës.

## **Grumbullimi i të dhënave**

***Rekomandimi nr. 3 i Këshillit të Evropës. Të shtyhet faza e numërimit të popullatës dhe ekonomive familjare përmes regjistrimit të popullsisë derisa të sigurohet një nivel maksimal i pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve, dhe regjistrimi të kryhet në pajtim me standardet ndërkombëtare.***

Në Kosovë, disponueshmëria e të dhënave statistikore të besueshme mbi strukturën etnike të popullatës është faktor kyç në zbatimin e KKKPK. Ekzistimi i të dhënave të tilla nuk përmbush vetëm kushtin për të siguruar një politikë efektive për komunitetet, por është edhe një kusht paraprak për edhe një sërë qëllimesh tjera në Kosovë:

- në administratën publike, rezultatet e regjistrimit do të përdoren si pikë referuese kritike për të siguruar barazi në shpërndarjen e burimeve publike, në shërbimet qeveritare dhe në përfaqësimin.
- në të gjitha elementet e sistemeve statistikore kombëtare, prodhon statistika në fusha të vogla ose komunitete të vogla, grupe pa gabime minimale të mostrave të zgjedhura.
- rezultatet e regjistrimit të popullsisë përdoren si një objektiv për kërkime dhe analiza, siç është parashikimi i popullsisë, duke përfshirë edhe strukturën etnike, të cilat janë vitale për të gjitha segmentet e sektorit publik dhe privat.

Prandaj, realizimi i regjistrimit të popullsisë është i volitshëm së bashku me nevojën e përgjithshme për zhvillimin e mëtejshëm social dhe ekonomik në Kosovë.

Aktualisht, nuk ka të dhëna të besueshme për strukturën e popullsisë. Regjistrimi i fundit i popullsisë i vitit 1991 siguroi të dhëna të kufizuara në nivel shumë të ulët të detajeve gjeografike. Rezistenca për të mos marrë pjesë në regjistrim rezultoi me mbulim të pakompletuar. Si i tillë, rezultatet e fundit të regjistrimit nuk janë nxjerrë për të implementuar masat specifike në fushën e politikës së pakicave. Nevoja për regjistrim të popullsisë edhe më tutje është urgjente për shkak të ndryshimeve specifike lidhur me strukturën etnike të popullsisë që nga viti 1999.

IPVQ-të janë të përkushtuara që të sigurojnë që regjistrimi i popullsisë në Kosovë të respektojë standardet ndërkombëtare duke mbuluar gjerësisht të gjitha komunitetet, duke vlerësuar në të njëjtën kohë urgjencën e gjetjes së të dhënave demografike për të mbështetur përpjekjet e IPVQ-ve në zhvillimin dhe implementimin e politikave, programeve dhe legjislacionit për pakicat. Data për regjistrimin e paraparë akoma nuk

është caktuar. Duke marrë parasysh fazën e planifikimit e cila merr shumë kohë, IPVQ-të, së bashku me komunitetin ndërkombëtar, aktualisht janë duke u përgatitur për organizimin e regjistrimit. Janë planifikuar dhe zhvilluar aktivitete të vazhdueshme dhe të mëparshme nga Zyra statistikore e Kosovës (ZSK) dhe sipas një projekt për ndihmë teknike<sup>3</sup> është themeluar ad hoc një Mision ndërkombëtar për monitorimin e regjistrimit të popullsisë, i mbështetur nga Agjencia Evropiane për Rindërtim, dhe Ministria e Shërbimeve Publike e IPVQ-ve (MSHP).

Në nëntor të vitit 2006, ZSK, së bashku me ekspertë të projektit bashkërisht përfunduan një regjistrim pilot për të analizuar dhe vlerësuar komponentët e ndryshme të procesit të regjistrimit të popullsisë, me synim të hartimit të planit dhe organizimit të tërë regjistrimit të popullsisë. Pilot regjistrimi i popullsisë u miratua nga Komisioni Qendror i Regjistrimit, më 18 tetor 2006. Pilot regjistrimi u bë në komunën e Kamenicës, Pejës dhe Shtërpçës. Këto tri komuna u zgjedhën në bazë të asaj se secila është e përbërë me proporcione të ndryshme me popullatë multi-etnike. Pilot regjistrimi kishte kryesisht vlerë teknike. Modeli statistiki nuk është përfaqësues i Kosovës si tërësi. Si i tillë, ky ushtrim ishte një mundësi për të testuar përgatitjen dhe vlerësimin e të gjitha procedurave të regjistrimit, d.m.th. pyetësorët, doracakët, formularët tjerë të regjistrimit dhe përkthimin e tyre, hartat dhe mjetet e sistemit informativ gjeografik,<sup>4</sup> trajnimin e stafit në terren, aktivitetet në terren, marrjen e të dhënave dhe procesimi i komponentëve, hedhja në tabelë e të dhënave, fushata informative për identifikimin e problemeve teknike dhe operacionale, të cilat mund të paraqiten gjatë regjistrimit të plotë, ose për të kuptuar ku mund të paraqiten korrigjime, për të siguruar nivel të lartë të cilësisë në rezultatet e regjistrimit të popullsisë.

Regjistrimi pilot në shumë aspekte është vlerësuar pozitivisht nga Eurostat dhe nga ekspertët e projektit.<sup>5</sup> Në përgjithësi, pilot regjistrimi e afrooi ZSK që teknikisht të jetë më e përgatitur për drejtimin e regjistrimit. Një e arritur e veçantë e pilot regjistrimit ishte miratimi progresiv i një “kulture të regjistrimit” brenda ZSK, me përfitimin e njohurive specifike dhe vlerësimin e të gjitha fazave të ndryshme, lidhur me përgatitjen dhe realizimin e një regjistrimi të popullsisë. Vlerësimi, akoma po detekton fusha, teknike dhe joteknike, të cilat kanë nevojë për vlerësim para se t’u jepet mundësia të planifikojnë dhe ndërmarrin regjistrimin e plotë, në harmoni me standardet ndërkombëtare. Në veçanti, përfshirja e të gjitha komuniteteve në regjistrim mbetet një pengesë. Në dy nga komunat e zgjedhura për pilot regjistrim, Kamenicë dhe Shtërpçe, numëruesit serb të Kosovës, në ditën e numërimit, refuzuan të marrin pjesë në grumbullimin e të dhënave, duke raportuar se kështu ishte kërkuar të veprojnë nga autoritetet lokale serbe. Në mënyrë të njëjtë, numëruesit romë refuzuan të fillojnë aktivitetet në terren, duke raportuar se përfaqësuesit romë në komunën e Kamenicës nuk e kishin autorizuar pjesëmarrjen e tyre.

---

<sup>3</sup> E titulluar “Mbështetje për sistemin statistikor dhe përgatitja për regjistrimin e popullsisë – Kosovë”, një projekt i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim. Kontraktorët janë Instituti Kombëtar i Statistikave të Italisë (ISTAT), Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT), Qendra Kërkimore Ndëruniversitare për Zhvillim të Qëndrueshëm, Universiteti i Romës “La Sapienza” (SIRPS).

<sup>4</sup> Një grumbullim i hardverit dhe softuerit kompjuterik, dhe të dhënat gjeografike për marrjen, menaxhimin, analizimin dhe ekspozimit të të gjitha formave të informacioneve të referuara gjeografikisht.

<sup>5</sup> Raporti për regjistrimin pilot është në dispozicion nga Zyra statistikore e Kosovës.

Kështu, popullata serbe dhe rome nuk janë mbuluar në këtë pilot regjistrim. Nuk është e mundshme të verifikohet nëse kjo është bërë vetëm për shkak të kundërshtimit të autoriteteve lokale, apo ishte qëndrim i përgjithshëm edhe i banorëve. Kjo ngrit një sërë rreziqesh dhe supozimesh të cilat ka nevojë të vlerësohen para organizimit të regjistrimit të plotë. Edhe pse këto mund të jenë joteknike, ata sërish kanë rëndësi teknike meqë mund të shpien në mbulim të pakompletuar.

Në rrethanat e tilla, kur ambienti social dhe politik nuk është në favor të drejtimit të një regjistrimi të suksesshëm, IPVQ-të ndoshta do të duhet të kenë parasysh edhe zgjidhje alternative për të plotësuar nevojën e të dhënave. Përndryshe, organizimi i regjistrimit në Kosovë mund të shpejtojë një relacion të vështirësuar, me njërin nga parimet fundamentale të regjistrimit, përkatësisht “mbulimit të plotë dhe universalitetit brenda një territori të përcaktuar”, duke rrezikuar vlefshmërinë e gjithë aktivitetit.

***Rekomandimi nr. 4 i Këshillit të Evropës. Marrja e masave për të siguruar mbrojtje efektive të të dhënave personale lidhur me bashkimin në komunitet.***

Qeveria e Kosovës aktualisht i ka dërguar një Projektligj për mbrojtjen e të dhënave (Projektligji) Kuvendit të Kosovës. Ky projektligj do të sigurojë njërën prej të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut; mbrojtjen e të drejtave të individit për privatësi dhe vetidentifikim vullnetar lidhur me mbledhjen dhe regjistrimin e të dhënave personale.

Në Kosovë ekziston një nevojë e madhe për një ligj mbi mbrojtjen e të dhënave, veçanërisht lidhur me nevojën për procesimin e të dhënave për bashkimin në komunitet. Këto të dhëna janë jetike për drejtimin dhe monitorimin e politikave qeveritare, siç është performanca në mesin e komuniteteve në faza të ndryshme të edukimit, të programeve shëndetësore, dhe përmbushjen e obligimeve statusore sipas Ligjit kundër diskriminimit, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/32, 20 gusht 2004. Kështu, projektligji është legjislacion kritik për Kosovën, i hartuar për të zhvilluar procedurat për mbledhjen dhe regjistrimin e të dhënave personale të të gjitha organeve publike dhe atyre jopublike, duke përfshirë gjithashtu zyrat konzulore diplomatike dhe zyra të tjera të përfaqësimit zyrtar të Kosovës jashtë vendit. Me hyrjen e tij në fuqi, Kosova do të ketë një kornizë normative për të siguruar një sistem konsistent të procesimit të të dhënave për bashkimin në komunitet, në pajtim me parimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Sipas projektligjit për mbrojtjen e të dhënave, neni 6, të dhënat personale lidhur me bashkimin në një komunitet janë klasifikuar si të dhëna personale të ndjeshme. Nën këtë klasifikimi, në mes tjerash, janë grupet etnike dhe kombësitë. Statusi i tillë nënkupton se të dhënat mbi prejardhjen etnike dhe kombësinë mund të procedohen, d.m.th. mblidhen, vetëm në raste të kufizuara, dhe personi të cilit i referohen të dhënat duhet të ketë dhënë pëlqimin e tij eksplicit. Të dhënat e ndjeshme personal kërkojnë edhe një sistem arkivimi specifik me qasje të kufizuar. Gjatë procesimit, të dhënat specifike personale duhet të shënohen dhe mbrohen në mënyrë specifike, për të siguruar parandalimin e qasjes në to të peronave të paautorizuar, përveç rasteve kur individi të cilit i referohen të dhënat e ndjeshme personale, publikisht shpall se nuk ka ndonjë qëllim të qartë apo eksplicit për kufizimin e përdorimit të tyre.

Këshilli Kombëtar Mbikëqyrës për Mbrojtjen e të Dhënave (tash e tutje Këshilli Kombëtar Mbikëqyrës) është i paraparë në projektligj, neni 37. Si organ i pavarur, duke iu përgjigjur vetëm KK, Këshilli Kombëtar Mbikëqyrës do të ketë mandat të bëjë inspektime për zbatimin e dispozitave të ligjit, t'u japë opinione të veta ministrive, KK-së, autoriteteve komunale dhe institucioneve të tjera kosovare lidhur me përputhshmërinë, dhe të paraqesë kërkesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjeve, të rregulloreve dhe akteve të përgjithshme, të nxjerra për të ushtruar pushtetin publik që drejtpërsëdrejti apo të tërthortë dhe që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave.

**Rekomandimi nr. 5 i Këshillit të Evropës. *Krijimi i një sistemi të përhershëm për grumbullimin e të dhënave mbi hetimin dhe ndjekjen penale të incidenteve të bazuara në prejardhjen etnike.***

Grumbullimi i informacioneve për hetimin dhe ndjekjen penale të incidenteve të bazuara etnike në gjykata dhe zyra të prokurorive bëhet përmes mbajtjes së librave të gjykatës. Çdo gjykatë ka librat e veta ku regjistrohen të gjitha rastet si dhe informacionet e marra gjatë procesit gjyqësor, duke iniciuar regjistrimin e një rasti të veçantë dhe duke përfunduar me përmbylljen e një rasti të caktuar. Të gjitha informacionet në raportet e gjykatës merren nga këto libra. Procesi i raportimit bëhet me dorë.

Me përkrahjen e Agjencisë Evropiane për Rindërtim, Këshilli Gjyqësor i Kosovës aktualisht është në fazën e fundit të instalimit të rrjetit të bazës së të dhënave për grumbullimin e të dhënave, duke përfshirë incidentet e motivuara etnike, për të gjitha rastet nën hetime dhe ndjekje penale. Pas kompletimit, gjyqësori do të ketë sistem të kompjuterizuar të lidhur me të gjitha gjykatat dhe objektet e prokurorive, të mbështetur nga softueri për menaxhimin e të gjitha llojeve dhe niveleve të rasteve në gjykatë dhe prokurori. Qëllimi i projektit është që të kemi shkëmbim të rregullt të informacioneve në mes të gjykatave dhe prokurorive, duke përfshirë edhe procesimin automatik të raporteve.

Gjyqësori i Kosovës do të përfitojë shumë nga baza e kompjuterizuar e të dhënave. Do të përmirësohen kushtet e punës në gjykata dhe prokurori dhe do të zvogëlohet koha e zgjidhjes së rasteve, dhe do të rritet transparenca e gjyqësorit, meqë qasja në informacione lidhur me rastin specifik do të jetë në dispozicion gjatë tërë kohës.

**Mjetet juridike dhe zbatimi i ligjit**

**Rekomandimi nr. 6 i Këshillit të Evropës. *Rritja e përpjekjeve për përmirësimin e funksionimit të gjyqësorit dhe krijimi i besimit të komuniteteve pakicë në gjykata, mes tjerash, me rekrutimin e personave të tjerë të cilët u përkasin pakicave dhe duke përsheptuar hapin për trajtimin e rasteve.***

Ministria e Drejtësisë (MD) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës <sup>6</sup> janë përgjegjës për administrimin e drejtësisë në mbarë Kosovën. Që të dyja punojnë në partneritet të

<sup>6</sup> I themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/52, 20 dhjetor 2005.

ngushtë me Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut (dhe mbikëqyren nga ai). Për të siguruar paanshmërinë dhe pavarësinë, gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë u janë besuar trajtimet e rasteve të ndjeshme që kanë të bëjnë me krimet ndëretnike, apo rastet ku ka rrezik serioz të anësisë.

MD ka miratuar një plan strategjik pesëvjeçar (2006-2011), me qëllim të përforcimit të kapaciteteve të brendshme dhe për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve të ofruara nga MD. Për të ndërtuar besimin e komuniteteve është esenciale që MD dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës të kenë në radhë të parë aftësinë për të ofrojnë drejtësi të paanshme dhe që gjyqësori të përfaqësojë popullatën multi-etnike në Kosovë.

Pas krijimit të sistemit gjyqësor në Kosovë, vështirësia për të bindur pjesëtarët e komunitetit pakicë që të marrin pjesë në gjyqësor është bërë evident. Prandaj, u ndërmorën veprime shtesë për rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga pakicat. Në vitin 2005, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve ishte 308, në mesin e të cilëve 14 ishin serb të Kosovës dhe shatë gjyqtar nga grupet tjera minoritare. Numri i përgjithshëm i prokurorëve në vitin 2005 ishte 89, nga të cilët dy ishin serb të Kosovës dhe gjashtë nga grupet tjera të pakicave. Numri i prokurorëve të pakicave të tjera u zvogëlua gjatë kësaj periudhe.

Sa u përket rekrutimeve të mëtejshme të personave që u përkasin pakicave, më 27 prill 2006, hyri në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/25 mbi Kornizën rregullative për sistemin e gjyqësisë në Kosovë. Ky ligj vëmendje të posaçme i kushton që gjyqësori dhe shërbimet e prokurorisë të reflektojnë karakterin multi etnik të Kosovës. Vlen të theksohet se ligji parashihet se në rastin nëse serbët e Kosovës paraqesin më pak se tetë për qind në gjyqësor dhe në prokurori, ligji mbështet veprimet afirmative të hartuara nga komuniteti serb i Kosovës, që në shënjestër ka rekrutimin e personave të kualifikuar që i përkasin këtij komuniteti. Programet e njëjta të veprimeve afirmative zbatohen për komunitetet tjera joshqiptare nëse ata përbëjnë më pak se 15 % të shërbimeve të gjyqësorit dhe të prokurorisë.<sup>7</sup>

Në kohën kur Rregullorja e UNMIK-ut 2006/25 hyri në fuqi, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve ishte 303, nga të cilët 13 ishin serbë të Kosovës, nëntë boshnjakë të Kosovës, katër turq dhe tre nga komuniteti rom, ashkanli dhe egjiptian (nuk janë dhënë informacione të detajuara për secilin nga të tre gjyqtarët për të identifikuar se me cilin nga komuniteti rom, ashkanli dhe egjiptas ai u bashkua). Numri i përgjithshëm i prokurorëve ishte 86, nga të cilët dy ishin serbë të Kosovës, katër boshnjakë dhe një turk.

Në vitin 2007, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve ishte 308, nga të cilët 15 ishin serbë të Kosovës, dhjetë boshnjakë të Kosovës, pesë turq dhe katër persona nga komuniteti rom, ashkanli dhe egjiptian. Numri i prokurorëve në vitin 2007 ishte 88, nga të cilët tre ishin serbë të Kosovës, katër boshnjakë të Kosovës dhe një turk.

Prandaj, përkundër përpjekjeve për të rekrutuar nga komuniteti serb i Kosovës, siç tregojnë edhe shifrat, ndërmjet 2005 dhe 2007 vetëm një gjyqtar shtesë serb i Kosovës

---

<sup>7</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2006/25, neni 2.

dhe vetëm një prokuror shtesë serb i Kosovës mund të rekrutoheshin, kurse numri i gjyqtarëve nga komunitetet e papërfaqësuar sa duhet u rrit dukshëm (12 gjyqtarë shtesë nga pakicat tjera). Prandaj, kërkohen përpjekje edhe më të mëdha për të përmirësuar përfaqësimin e këtyre komuniteteve në gjyqësor. Ashtu siç është tani, niveli aktual i përfaqësimit i komuniteteve joshqiptare në gjyqësi dhe në shërbimet e prokurorisë, nuk është i kënaqshëm në proporcion me popullatën e përgjithshme. Në të vërtetë, niveli i pjesëmarrjes akoma mbetet relativisht i ulët.

***Rekomandimi nr. 7 i Këshillit të Evropës. Sigurimi që bartja e institucionit të Ombudspersonit në institucion vendor të mos e dëmtojë efektivitetin e institucionit apo të shkatërrojë besimin që e ka ndërtuar deri më sot në mesin e komuniteteve të pakicave.***

Në dhjetor të vitit 2005 përfundoi mandati i Ombudspersonit ndërkombëtar. Deri atëherë bartja në subjekt vendor gati ishte përfunduar. Ushtruesi i detyrës së PSSP-së në atë kohë caktoi një zëvendësombudsperson me prejardhje etnike shqiptare si ushtrues i detyrës së Ombudspersonit derisa të emërohej Ombudspersoni vendor. Kur u largua Ombudspersoni ndërkombëtar akoma nuk kishte ligj për emërimin e Ombudspersonit vendor – Rregullorja ekzistuese e UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi themelimin e institucionit të Ombudspersonit në Kosovë<sup>8</sup> parashihte një Ombudsperson ndërkombëtar i cili do t'i raportojë drejtpërsëdrejti PSSP-së.

Në shkurt të vitit 2006, PSSP-ja shpalli Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë (IOK), që siguroi bazën ligjore për emërimin e një ombudspersoni vendor të zgjedhur nga KK, dhe i cili duhej t'i raportojë KK. Kjo e përfundonte bartjen në institucion vendor. Përmbajtja e Rregullore parasheh, mes tjerash, hartimin e rregullore së punës për rekrutimin dhe emërimin e Ombudspersonit të ri, një detyrë të cilën KK asnjëherë më parë nuk e kishte bërë. Kjo rregullore e punës u miratua kah mesi i vitit 2006 dhe procesi i ardhshëm i rekrutimit u bë në dhjetor të vitit 2006. Votimi në KK në atë kohë nuk çoi në emërimin e Ombudspersonit të ri sepse asnjëri nga kandidatët nuk kishin fituar numrin e nevojshëm të votave nga shumica e deputetëve të KK. Një procedurë e re e rekrutimit aktualisht është duke vazhduar dhe është në pritje.

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2007/15 për ndryshimin e Rregullore së UNMIK-ut nr. 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë,<sup>9</sup> IOK do të ketë katër zëvendësombudspersona, nga të cilët njëri do të jetë nga komuniteti shqiptar i Kosovës, njëri nga komuniteti serb, dhe së paku një nga komunitetet tjera joshqiptare dhe joserbe. Çdo zëvendës do të veprojë në cilësinë e tij individuale por që bashkërisht do të përfaqësojnë diversitetin etnik të shoqërisë kosovare.

Për të implementuar mandatin e ri IOK ka miratuar rregulloren e punës. Në praktikë, ankesat individuale pranohen qoftë personalisht ose përmes postës, faksit ose postës elektronike. Inicohen hetime sipas detyrës zyrtare (ex officio) pasi të pranohen

---

<sup>8</sup> Miratuar më 30 qershor 2000.

<sup>9</sup> Miratuar më 19 mars 2007.

informacione të caktuara që tregojnë se është bërë shkelje e të drejtave të njeriut. Pasi që IOK të ketë marrë të gjitha informacionet e nevojshme nga ankuesi (ose, në rastin e hetimit sipas detyrës zyrtare, nga disa burime), IOK pas diskutimeve me avokatin kompetent dhe me stafin e lartë, do të vendosë për veprimet adekuate që duhet t'i ndërmerr. Kjo mund të përfshijë takime të nivelit të lartë të IPVQ-ve, shkresa intervenimi, kërkesa për masa të përkohshme dhe, kur të gjitha masat tjera të jenë shterur, IOK do të nxjerrë një raport duke përfshirë edhe analizën ligjore të situatës dhe rekomandimeve.

Duhet theksuar se gjatë mungesës së një Ombudspersoni të ri, IOK, nën udhëheqjen e përkohshme, ka vepruar pa vështirësi. Në fakt, puna e përditshme e IOK ka vazhduar pak a shumë e papenguar. Duke ditur situatën e pazakontë në të cilën ndodhet, autoriteti dhe legjitimiteti nën udhëheqësinë e përkohshme kanë mbetur të pacenuara. Derisa ka ekzistuar frika se do të zvogëlohet numri i ankuesëve nga komunitetet pakicë pas largimit të Ombudspersonit ndërkombëtar, statistikatat tregojnë se që nga janari i vitit 2006, numri i ankuesve të tillë ka mbetur në shkallën e njëjtë, kurse numri i përgjithshëm i ankesave është rritur. Përafërsisht një e treta e ankesave të pranuar nga IOK janë dorëzuar nga pjesëtarë të komuniteteve pakicë, ashtu siç është raportuar në raportin e shtatë vjetor të IOK, të botuar në korrik të vitit 2007.

IOK, nën drejtimin vendor, në mënyrë efektive ka ndërhyrë në çështjet lidhur me të drejtat e njeriut, p.sh. në një shkresë të datës 5 korrik 2007, IOK kërkoi nga Kryeministri të suspendojë praktikën e implementuar nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) për kushtëzimin e regjistrimit të automjeteve të reja dhe riregjistrimin e të vjetrave me pagesën e faturave të energjisë elektrike.

Pranohet se mandati i ri i IOK, i kufizuar për IPVQ-të, nënkuptonte se një numër i rasteve në pritje duhej të mbylleshin, ku përfshihej edhe UNMIK-u, për shkak të mungesës së kompetencave. Ky skenar është një pasojë fatkeqe e bartjes së IOK në subjekt vendor, pa mandat për të vepruar në raste të tilla.

Një test për IOK është të përmirësojë mbikëqyrjen e gjendjes së të drejtave të njeriut në veri të Mitrovicës, ku ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit është kufizuar dhe nuk ka fare kontakte me autoritetet. Serbët e Kosovës në këtë pjesë vazhdojnë të refuzojnë të gjitha format e bashkëpunimit me IPVQ-të, përkundër faktit se Institucioni ka nënzyrë në të cilën kanë qasje të gjithë banorët. Një situatë e ngjashme ekziston në komunën e Shtërpcës. Prandaj, situata aktuale politike dhe mungesa e integritetit të komuniteteve e dëmton mbikëqyrjen e IOK mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në këto pjesë të Kosovës.

**Rekomandimi nr. 8 i Këshillit të Evropës. *Trajtimi i mosndëshkimit të perceptuar lidhur me krimet e motivuara etnike duke i dhënë krimin të tillë prioritetin më të lartë në kuadër të zbatimit të ligjeve dhe organeve të tjera të përfshira, dhe ndërmarrja e hapave për raportimin e manifestimeve të përditshme të mostolerancës.***



Shih komentet nën Rekomandimin nr. 9

### ***Procesi i kthimit dhe shqetësimet e sigurisë***

**Rekomandimi nr. 9 i Këshillit të Evropës. *Ndërmarrja e masave energjike për heqjen e pengesave për kthim të qëndrueshëm, duke trajtuar seriozisht shqetësimet e sigurisë të serbëve dhe të tjerëve dhe duke siguruar riposedimin dhe qasjen e papenguar në tokën bujqësore dhe në pasurinë tjetër, duke përfshirë edhe implementimin e legjislacionit të miratuar rishtazi, dhe duke paraparë edhe aktivitete të tjera për gjenerimin e të ardhurave.***

Në korrik të vitit 2006, UNMIK dhe IPVQ-të miratuan një dokument të politikave të reja “Doracak i spastruar për kthim të qëndrueshëm”, duke prezantuar mekanizma dhe strategji gjithëpërfshirëse për kthim nga UNMIK dhe IPVQ. Ky doracak riafirmon standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira dhe paraqet një qasje të thjeshtë dhe të efektshme për kthimet, me synimin për të krijuar kushte të qëndrueshme për riintegrim efektiv të personave të kthyer, dhe krijimin e një mekanizmi institucional të fortë dhe mbështetës në nivel lokal dhe qendror për një qëllim të tillë. Me doracakun e spastruar për kthime të qëndrueshme UNMIK dhe IPVQ kanë krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse për trajtimin e të gjitha pengesave për kthimin dhe riintegrimin. Përfshin masa të ndryshme nga sigurimi i shërbimeve shoqërore për personat e kthyer, avancimi i qasjes së PZHBV/refugjatëve në skemat e ndihmave, mekanizma të përmirësuar të mbrojtjes për të siguruar mosdiskriminimin deri tek inkorporimi i nevojave për kthim dhe i shqetësimeve në zhvillimet komunale dhe qendrore dhe në planifikimin e buxhetit.

Strategjitë komunale për kthim për vitin 2007 janë përpiluar dhe janë miratuar në 22 komuna dhe katër të tjera presin miratimin. Implementimi i këtyre strategjive mbetet i pakënaqshëm për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Deri tani këtë vit janë lançuar gjashtë projekte për kthim të organizuar të cilët kanë kushtuar 3.7 milion €, e që u dedikohen kthimit të 140 familjeve në Lipjan, Mëhalla Abdullah Presheva në Gjilan, Vushtrri, Berkovë, Klinë, Lismir, Nakaradë, Fushë Kosovë, Klinavc dhe në Klinë.

Mirëpo, numri i kthimit të pakicave akoma është duke u zvogëluar. Një numër i madh i PZHBV dhe i refugjatëve të cilët i braktisën shtëpitë e tyre në vitin 1999, kanë vendosur të marrin banim të përhershëm në vendin ku ata jetojnë aktualisht, apo gjetiu jashtë Kosovës pasi që kanë jetuar si refugjatë për shtatë apo më shumë vite. Ky skenar reflektohet në numrin e pritur të kthimeve vullnetare për vitin 2008 të komunitetit serb të Kosovës, boshnjakëve, romëve, ashkanli ve dhe egjiptianëve.<sup>10</sup>

Përkundër këtij skenari, IPVQ-të janë të përkushtuar të sigurojnë zbatimin e masave për të përkrahur përmirësimin e gjendjes së sigurisë në Kosovë për personat e kthyer, veçanërisht ato të komunitetit serb. Përpjekjet për të përforcuar gjyqësorin, përmirësimin e qasjes në pasurinë, dhënien e statusit zyrtar gjuhëve të pakicave në nivel komunal,

---

<sup>10</sup> Statistikat mujore të UNHCR për kthimet vullnetare në Kosovë.

programet e punësimit dhe trajnimi i Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) përbëjnë një pjesë të detyrës së përforcimit të sigurisë së komuniteteve dhe rritjes së besimit të komuniteteve në sundimin e së drejtës dhe mekanizmat e zbatimit të ligjit.

#### *Kryerja e detyrave policore në komunitet*

SHPK-ja është institucion kyç në ofrimin e sigurisë efektive për personat e kthyer. Luan një pjesë të rolit në krijimin e kushteve të qëndrueshme duke zbatuar masat të cilat mbrojnë pakicat dhe interesat e personave të kthyer, si dhe mbështesin procesin e pajtimit të komuniteteve. Në dy vitet e fundit, UNMIK dhe IPVQ kanë bërë disa përpjekje për të përmirësuar sigurinë e komuniteteve dhe për këtë qëllim kanë krijuar apo përforcuar mekanizmat ekzistues të sigurisë. Çelësi për adresimin e shqetësimeve të sigurisë për personat e kthyer është pjesëmarrja aktive e të gjitha komuniteteve në ruajtjen e sigurisë efektive. Si e tillë, SHPK dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) në mënyrë aktive po e përcjellin rekrutimin në mesin e komuniteteve.<sup>11</sup> Aktivitete e policisë në mesin e komuniteteve janë zgjeruar me themelimin e këshillave komunale për sigurinë e komunitetit dhe komiteteve lokale për siguri publike, të paraparë në Rregulloren e UNMIK-ut 2005/54. Në çdo stacion policor të SHPK-së ekziston një divizion i komuniteteve dhe një zyrtar për komunitete. Caktohet një zyrtar i cili për së afërmi kontakton me popullatën lokale për çdo fshat në Kosovë.

#### *Liria e lëvizjes*

Liria e lëvizjes për pjesëtarët e komuniteteve pakicë është përmirësuar edhe më shumë me rritjen e linjave të sistemit të transportimit humanitar me autobus. Shërbimi humanitar me autobus dhe hekurudhat e Kosovës në muaj bartën deri më 28,500 dhe 32,000 udhëtarë. Përveç kësaj, një shërbim me autobus komercial që lidh Graçanicën me fshatrat serbe të Kosovës në veri të Prishtinës u lancua më 13 qershor të vitit 2007, me mbështetjen e komunës.

Gjatë periudhës janar deri në mars 2007, OSBE-ja ka vëzhguar dhe ka raportuar se përgjatë 13 linjave të monitoruara, shërbimi humanitar i autobusëve funksionon relativisht mirë dhe udhëtarët përgjithësisht janë të kënaqur me këtë cilësi. Edhe pse në disa raste nuk ka numër të mjaftueshëm të ulëseve dhe autobusët janë të stërngarkuar, shumica e përfituesve kanë qasje në këtë shërbim rregullisht.<sup>12</sup> Si i tillë, rritja e lirisë së lëvizjes u mundëson të kthyerve serbë të Kosovës që të kenë mundësi më të shumta të vizitojnë qytetet kryesore dhe të bashkëveprojnë me popullatën shqiptare të Kosovës derisa po blejnë, duke i përdorur bankat lokale dhe duke pasur qasje në shërbimet publike komunale.

Që nga 1 janari 2007, përgjegjësia është e Ministrisë së Transportit dhe Post e Telekomunikacionit (MTPT) për këtë sistem, pas marrëveshjes operacionale për transferimin e kompetencave të transportit humanitar për komunitete pakicë në Kosovë,

<sup>11</sup> Aktualisht 10,22 % e stafit të SHPK janë serbë të Kosovës, 3.10 % boshnjak të Kosovës, 1.19 % turq të Kosovës, 0.52 % goranë të Kosovës, 0.32 % romë të Kosovës, 0.29 ashkanli të Kosovës dhe 0.10 % egjiptianë. Burimi – Shërbimi Policor i Kosovës.

<sup>12</sup> Ka 1-2 autobusë që veprojnë në secilën nga 16 linjat operative të sistemit të transportimit humanitar.

të nënshkruar në mes të UNMIK-ut dhe IPVQ. IPVQ janë duke siguruar vazhdimësinë e këtij shërbimi dhe korniza e saj mbështetëse institucionale është përfundimisht duke u kompletuar. Megjithatë, perceptimi i frikës për incidentet e sigurisë në mesin e disa anëtarëve të komunitetit serb akoma mbetet, këta persona vazhdojnë në masë të madhe të qëndrojnë apo të udhëtojnë në viset ku ata janë shumicë.

### *Kthimi i pasurisë*

Për të trajtuar çështjen e pasurisë së mbetur, fillimisht UNMIK-u themeloi Drejtorinë për Çështje Banesore Pronësore (HPD) dhe Komisionin e Ankesave për Çështje Banesore Pronësore (HPCC) për të trajtuar kthimin e pasurisë së mbetur pas konfliktit. Përkundër vështirësive që i ka pasur institucioni vitin e parë, HPD/HPCC në pjesën më të madhe e ka përmbushur mandatin. HPD/HPCC ka zbatuar 28, 828 vendime lidhur me ankesat për pasurinë e mbetur (98.9 % e numrit të përgjithshëm të rasteve nga 29,741 ankesa).<sup>13</sup> Pjesa e mbetur prej 332 vendime do të implementohet gjatë muajve të ardhshëm.<sup>14</sup> Arsyeja për vonesë në zbatim është se vendimet në fjalë presin të shqyrtohen. Pranohet se në këto raste “zbatimi” nuk do të thotë domosdoshmërisht se ankuesi ka marrë sërish në riposidim (dhe/ose kthyer). Kjo do të thotë qoftë se:

- a) pronari ka zgjidhur privatisht dhe më nuk ka pasur nevojë për shërbimet e HPD (që zakonisht nënkupton shitjen);
- b) prona është shkatërruar ashtu që nuk nevojitet administrata;
- c) prona administrohet nga HPD;
- d) rasti është refuzuar;
- e) pronari ka marrë në posedim pronën.

Mandati i HPD/HPCC është paraparë të trajtojë ekskluzivisht konfliktet që kanë të bëjnë me ankesat për pasurinë e mbetur. Derisa pasuria e paluajtshme, e cila ishte bashkuar me vendbanimin ishte nën mandatin e HPD/HPCC, prona private bujqësore dhe komerciale ishte lënë jashtë procesit. Për ta ndryshuar këtë situatë, siç është përcaktuar nga Kai Eide në “Rishikimin e tij gjithëpërfshirës të situatës në Kosovë” (Raporti i Kai Eide), më 4 mars 2006, Rregullorja e UNMIK-ut 2006/10, më vonë e zëvendësuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50, e themeloi Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), e cila është pasardhëse e HPD/HPCC. AKP është institucion vendor i pavarur me mandat për të zgjidhur të gjitha kontestet e pasurisë së mbetur të paluajtshme private, komerciale dhe bujqësore, që janë të lidhura me konfliktin.

AKP është e përbërë nga një Sekretariat Ekzekutiv, një Bord Mbikëqyrës dhe një Komision për ankesa pronësore (KAP), si një organ gjoja gjyqësor i përbërë nga dy anëtarë ndërkombëtarë dhe një banor i Kosovës. Pjesëmarrja e PSSP-së në mbikëqyrjen administrative dhe drejtimin e politikave në AKP është siguruar përmes emërimit të dy anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës nga Kryeministri i Kosovës.

<sup>13</sup> Periudha prej janarit 2001 deri në tetor 2007.

<sup>14</sup> Raporti përfundimtar i Komisionit të Ankesave për Çështje Banesore Pronësore.

Më 1 qershor 2007, Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2007/5 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 u shpall me qëllim të sigurimi të udhëzimeve të detajuara procedurale për organet kryesore të AKP.

Më 14 maj 2007, anëtarët e KAP u emëruan nga PSSP-ja. Zgjidhja e ankesave përbën fazën e parë të procesit të nevojshëm për kthimin e të drejtave dhe vendosjen e kushteve për kthim të qëndrueshëm. Sa i përket zgjidhjes së kontesteve të ankesave KAP merr vendim për pronën ndaj të cilës është parashtruar ankesë lidhur me titullarin, të drejtat mbi shfrytëzimin e tokës dhe të drejtat për posedim të ligjshëm. Duke marrë vendim mbi titullarin, ankuesit e suksesshëm do të kenë mundësi të regjistrojnë titullarin e konfirmuar në Regjistrin e Kosovës për të drejtat mbi pasurinë e paluajtshme. Vendimet e KAP janë të formës së prerë nëse ndaj tyre nuk parashtrohet ankesë. Për dallim nga mekanizmat e mëparshëm të HPD/HPCC, ndaj vendimeve të Komisionit mund të parashtrohet ankesë në Gjykatën Supreme për t'u vendosur nga paneli prej tre gjyqtarësh, dy ndërkombëtarë dhe një vendor. Çka është më me rëndësi, vendimet e KAP përbëjnë vendimet mbi titullarin, dhe kështu, ankuesit e suksesshëm të cilët kanë vendime të KAP do të kenë mundësi të regjistrojnë pronën e tyre (ose të drejtën e shfrytëzimit) në Regjistrin e Kosovës për të drejtat mbi pasurinë e paluajtshme. Informacionet për qasjen në ankesa dhe për procesin e pranimit të tyre sigurohen përmes zyrtarëve të AKP, ekipeve mobile brenda dhe jashtë Kosovës, fushatat në terren nga agjencitë joqeveritare dhe ndërkombëtare, si dhe nga IPVQ-të. Që nga shtatori 2007, AKP ka pranuar më shumë se 27, 494 ankesa për pasuri të mbetur private bujqësore apo komerciale.

Zgjidhja e ankesës pronësore nuk nënkupton domosdoshmërisht kthimin e peronave të zhvendosur. Pronarët e ligjshëm mund të mos kenë mundësi të marrin sërish në posedim pronën ose për shkak të shqetësimeve të sigurisë të mos dëshirojnë të marrin në riposedim shtëpitë e tyre që shpien në raste të riokupimit të paligjshëm. Në rastet e tilla legjislacioni në fuqi lejon veprimin sipas detyrës zyrtare të policisë për të larguar uzurpatorin e paligjshëm.<sup>15</sup> Mirëpo, për ta frenuar këtë skenarë, UNMIK kërkoi që procedurat standarde të SHPK për veprim të rishikohen për të siguruar zbatim adekuat, në pajtim me 13 parimet e "Grupit të Kontaktit" për zbatimin e standardeve. Për më tepër, Agjencia Kosovare e Pronës ka emëruar një pikë referuese për të monitoruar rastet e riposedimit në bashkëpunim me policinë.

Zbatimi i vendimeve të KAP për ankesat lidhur me tokën do të kenë nevojë për mjete të tjera përveç dëbimit nga lokalet e mbyllura, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në vendosjen e pasurisë nën administrim, lidhjen e marrëveshjeve për qiradhënie, konfiskimin dhe rrënimin e strukturave të paligjshme, si dhe ankandin, të cilat që të gjitha do të lehtësojnë dhe sigurojnë kthimin e pasurive mbajtësit të ligjshëm të të drejtave pronësore. Në këtë kontekst duhet përmendur implementimin e suksesshëm të skemës së qiradhënies e cila siguron të ardhura të rregullta mujore për mbajtësin e ligjshëm të titullarit të pronës, i cili ka vendosur që të mos merr në riposedim pronën e tij në momentin aktual për arsye të ndryshme. Personi që ka zënë pronën paguan një shumë të caktuar parash në fondin në emër të AKP-së, i cili ia paguan qiranë pronarit të ligjshëm.

---

<sup>15</sup> Neni 13.6 I Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 dhe neni 16.5 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50..

Duke marrë parasysh përvojën e procesit të HPD/HPCC-së nga AKP-ja, administrimi i tokës ka gjasa të jetë metoda kryesore e zbatimit të vendimeve të PCC-së.

## **Punësimi**

Ne korrik të vitit 2005, UNMIK-u, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe IPVQ-të nënshkruan një memorandum të mirëkuptimit për zbatimin e programit të kthimit të mbështetur nga qeveria e Kosovës. Përmes memorandumit të mirëkuptimit u formua korniza për projektin Zbatimi i partneriteteve të qëndrueshme të përkrahjes për kthimet në Kosovë që kap shifrën 8.800,000 euro, shumë e cila jepet nga buxheti e konsoliduar i Kosovës. Përmes këtij Programi ofrohet ndihmesa për kthimet individuale, spontane, grupe dhe të organizuara. Përveç ndihmës së strehimit dhe zhvillimit të komunitetit, programi gjithashtu ngërthen në vete një linjë shërbimi për ndihmë ekonomiko-shoqërore.

Sipas Entit Statistikor të Kosovës, Kosova ka përqindjen më të lartë të papunësisë në Ballkanin Perëndimor me mbi 40 % të papunë. Popullsia e Kosovës është shumë e re (gjysma e popullsisë janë nën moshën 25 vjeçare), dhe përafërsisht 30,000 punëkërkues i shtohen tregut të punës në vit. Në këtë situatë, pengesat për qasje në punësim janë edhe më të mëdha për pjesëtarët e komuniteteve pakicë, të cilët kanë pak njohuri apo fare nuk e njohin gjuhën e shumicës, dhe të cilët nuk ndihen të sigurt të lëvizin lirshëm me mjetet e tyre. Kjo vlen gjithashtu edhe për të kthyerit që kanë jetuar jashtë Kosovës për vite me radhë, dhe kanë njohurit të pakta për mënyrën e funksionimit të institucioneve publike.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nëpërmes zyrave rajonale dhe lokale të punësimit, është partnere zbatuese e programit për krijimin e punësimit të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Në fund të vitit 2006, pas dy vitesh veprimi, përmes Programit janë krijuar 5.000 vende të reja pune dhe janë themeluar më shumë se 800 partneritete me kompanitë e sektorit privat. Ky program ofron aftësi me pa shkëputje nga puna, aftësi para punësimit, subvencione për punësim dhe një skemë të praktikantëve. Sipas UNDP-së, 30 % e përfituesve të këtij projekti vijnë nga komunitetet pakicë. Dy programe të specializuara janë pjesë e Programit për krijimin e punësimit. "Organizata për Mbështetje të Bujqësisë" ndihmon bujqit në mënyrë individuale që të marrin pjesë së bashku në kooperativat bujqësore, ofron ndihmesë teknike, grante dhe organizoi aftësi. "Programi për tregun aktiv të punës" është krijuar si reagim ndaj përqindjes së lartë të papunësisë së të rinjve. Informacionet për procedurat e aplikimit për program mund të gjenden edhe në gjuhën serbe tek zyrat e punësimit në rajonet e banuara me pakica.

***Rekomandimi nr. 10 i Këshillit të Evropës. Të ndiqen planet të cilat do të bëjnë skemat e ndihmesës më fleksibile, gjë e cila do të sigurojë zgjedhjen e lirë të vendit të banimit në Kosovë për personat që u takojnë komuniteteve pakicë.***

Qëllimi kryesor i procesit të kthimit gjithmonë është kthimi i të shpërngulurve në vendin e lindjes së tyre. IPVQ ripohon të drejtën e çdo refugjati që të kthehet në vendin e

lindjes. Kjo është një ndër zgjidhjet më të qëndrueshme për të gjithë të shpërngulurit. Doracaku i plotësuar për kthimin e qëndrueshëm gjithashtu parasheh një ndihmesë për ndërtimin e pronave përcjellëse të banimit të para viteve 1999. Sidoqoftë, ndihma e ndërtimit për strehim nuk do t'ju lejohet nëse një anëtar i familjes posedon pronë banimi në Kosovë, së cilës anëtarët e familjes mund t'i qasen lirshëm apo në rastet kur kanë pronë banimi në Serbi ose në Mal të Zi.

Përveç kësaj, Doracaku i plotësuar për kthim të qëndrueshëm thekson parimin kryesor që personat e shpërngulur duhet të zgjedhin lirshëm dhe në mënyrë të informuar vendin e banimit, dhe rekomandon që skemat për ndihmesë do të jenë në dispozicion të atyre që dëshirojnë të kthehen në vendet e tjera nga ato të lindjes<sup>16</sup>. Rrjedhimisht, Doracaku i plotësuar për kthimet e qëndrueshme parasheh mundësinë për integrim lokal në vendin e origjinës apo të rivendosjes në lokacione të ndryshme nga ato ku kanë lindur dhe jetuar, dhe me këtë bën edhe zgjerimin e kriterit të përzgjedhjes së përfitueseve.

UNMIK-u dhe IPVQ-të janë në dijeni që Doracaku i plotësuar për kthim të qëndrueshëm nuk përmban procedura specifike që duhet të ndiqen në raste të tilla si të ndarjes së tokës dhe ndihmesës për rindërtimin e shtëpive, apo edhe të ofrimit të shtëpive të banimit në vendet e tjera nga to të prejardhjes. Kjo ka pasur implikime të ndryshme në projektet e kthimit, si në rastet e ndërtimit në tokën komunale pa leje komunale apo urbane të ndërtimit si dhe të ndarjes së tokës. Me qëllim të vlerësimit të mundësive për themelimin e procedurave më të qarta, mund të ketë nevojë për bashkëpunim me Departamentin e kadastrit.

***Rekomandimi nr. 11 i Këshillit të Evropës. Të aplikohen masa të ndihmesës dhe të bëhet shpërndarje më e qartë e përgjegjësiwe institucionale për të siguruar integrim të vazhdueshëm të atyre personave nga grupet pakicë që janë kthyer me forcë në Kosovë.***

Një hap i madh që është ndërmarrë në lehtësimin e riintegrit të personave të riatdhesuar në shoqërinë e Kosovës, që është miratuar nga IPVQ-të më 10 tetor 2007, është Strategjia e riintegrit të personave të riatdhesuar në Kosovë nga vendet nikoqire. Përveç dhënies së ndihmesës së menjëhershme në momentin e kthimit, përmes Strategjisë synohet të sigurohet zgjidhja e qëndrueshme dhe afatgjatë për nevojat e personave të riatdhesuar, sidomos në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe edukimit, punësimit, riintegrit ligjor, mirëqenies sociale, çështjeve të lidhura me banimin dhe pronën. Gjithashtu, përmes kësaj Strategjie trajtohen nevojat e pjesëve më të ndjeshme të shoqërisë dhe të komuniteteve pakicë. Në mënyrë specifike, aty rekomandohet diskriminimi pozitiv për grupet e pakicave në fushat si punësimi, arsimit dhe edukimi, riintegrimi ligjor dhe të tjera.

Strategjinë e ka bërë të nevojshme edhe fakti se individët e riatdhesuar ballafaqohen me shumë probleme në momentin e kthimit në Kosovë, sidomos në qasjen ndaj ndihmës sociale dhe regjistrimit civil, dhe në shumicën e rasteve sasia e kësaj ndihmese (ndihmës sociale) nuk është adekuate sidomos në rastin e atyre me prejardhje Rome, Ashkanlike dhe Egjiptiane. Shumë pak nga komunat i përfshijnë shpenzimet e lidhura me

---

<sup>16</sup> Doracaku i plotësuar për kthimet e qëndrueshme.

riatdhesimin dhe riintegrimin dhe kthimet vullnetare në buxhetet e tyre, duke preferuar më tepër kërkimin e fondeve shtesë për të financuar aktivitete të tilla. Pjesa më e madhe e asistencës ndërkombëtare ka të bëjë me përkrahjen e kthimit vullnetar. Aktualisht, përkundër ekzistimit të kornizës së politikave, nuk është hartuar ndonjë plan veprimi e as që janë ndarë mjete buxhetore, për asnjë program të caktuar të ndihmesës që do të përkrahte personat e riatdhesuar.

Strategjia është hartuar nga këshilli drejtues ndërministror që është bashkëdrejtuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Zyra për komunitete, kthime dhe pakica e UNMIK-ut, ndërsa në përbërje të tij kanë qenë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, organizatave ndërkombëtare dhe të ekspertëve të tjerë vendorë.

***Rekomandimi nr. 2 i Këshillit të Evropës. Të ndërmerren masa të tjera urgjente për trajtimin e gjendjes alarmuese shëndetësore të romëve në kampet e kontaminuara me plumb në Kosovën veriore, duke konsideruar shëndetin e romëve si çështje primare, dhe të ndërmerren masa shtesë për të lehtësuar kthimin e romëve dhe për të parandaluar krizat e tilla shëndetësore në të ardhmen.***

Për të trajtuar gjendjen shëndetësore të romëve në kampet e kontaminuara me plumb në Kosovën veriore, në pranverë të vitit 2006, gjithsej 91 familje (400 individë) u zhvendosen në Kampin Osterode. Në kuadër të këtyre familjeve, 43 prej tyre (198) individë ishin nga Zhitkovci, 22 familje (80 individë) ishin nga kazerma e Kabllarit dhe 26 familje vinin nga Çesmin Llugu. Objektet nga kampin Osterode, (më parë është shfrytëzuar nga KFOR-i francez) janë përmirësuar, pastruar dhe rinovuar. Përveç kësaj, për rreth një vit gjendja shëndetësore është monitoruar vazhdimisht me ndihmën e njohurive profesionale të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe në bashkëpunim me menaxhmentin e kampit të Ndihmës së Kishës Norvegjeze, si dhe me Departamentin e UNMIK-ut për Administratë Civile (DAC) për tu siguruar që personat e kontaminuar të marrin trajtim mjekësor, duke përfshirë furnizimin me ushqim të freskët.

Romët e zhvendosur brenda vendit që ende jetojnë në kampin Osterode (përafërsisht 700) pranojnë ndihmë mjekësore çdo ditë nga dy mjekë që punojnë në kamp. Përveç ndihmës mjekësore, mjekët përcjellin kushte jetësore dhe bëjnë analiza të gjakut. Objektet e romëve në kampin e Zhitkovcit dhe në kazermë të Kabllarit, të cilët refuzojnë të shkojnë në Osterode ende kanë qasje në shërbime mjekësore në këtë kamp.

Janë bërë përpjekje shtesë për rindërtimin e shtëpive dhe për ndërtimin e objekteve banesore në ish "Mëhallën Rome" (projekti për kthim në Mëhallën Rome) në Mitrovicën e Jugut me qëllim të mundësimin të kthimit të PZHBV-e romë. Në mars të vitit 2007, nëntë familje (51 individë) u zhvendosen nga kampi Osterode në kampin e Mitrovicës së jugut. Po kështu, edhe nëntë familje të tjera (48 individë) nga Osterode dhe Çesmin Llugë pritet të kthehen në Mëhallën Rome të rindërtuar në Mitrovicën e Jugut deri në tetor të vitit 2007. Në procesin e përzgjedhjes së përfutuesve, Komisioni komunal i përzgjedhjes i

kushton vëmendje të posaçme ndaj rasteve më të cenueshme, posaçërisht për personat e prekur nga kontaminimi me plumb.

Deri në fund të shtatorit të vitit 2007, Projekti për kthim në Mëhallën Rome ka mundësuar vendosjen e 164 personave në objekte banesore, ndërsa 165 romë janë kthyer në shtëpitë e rindërtuara private. Investimi në projektin e kthimit është zgjidhje e qëndrueshme për parandalimin e krizës së mundshme shëndetësore në të ardhmen dhe siguron objekte adekuate të banimit për ata persona dhe familje që mbesin në rrezik të kontaminimit të mëtejshëm. Në kë drejtim, Kuvendi komunal ka miratuar planin urbanistik për “Mëhallën Rome”, që parasheh ndërtimin edhe të pesë blloqeve banesore. Për shkak të kufizimeve buxhetore realizimi i këtij plani ende nuk është bërë.

Pas finalizimit të fazës së dytë të kthimeve, të planifikuara për tetor 2007, Projekti për kthim në Mëhallën Rome do të merret përsipër nga komuna dhe nga Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, i cili përbëhet prej 13 agjencive të OKB-së, nën udhëheqjen e UNDP-së (që do të zëvendëson ish-ekipin që përbëhej nga komuna, UNMIK-u, UNHCR-ja dhe OSBE-ja).

## **Kulturat e pakicave dhe çështjet e medieve**

**Rekomandimi nr. 13 i Këshillit të Evropës. Të rriten përpjekjet për mbrojtjen e vendeve fetare nga çfarëdo incidenti, duke vazhduar njëkohësisht procesin shumë të rëndësishëm të rindërtimit të vendeve të dëmtuara.**

IPVQ-të kanë shprehur përkrahjen e plotë për masat e mbrojtjes së trashëgimisë fetare dhe kulturore, të parapara në propozimin gjithëpërfshirës të Ahtisarit. Legjislatura është duke u hartuar, ndërsa aktivitetet në terren janë në vazhdim e sipër në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare për zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes me qëllim të sigurisë dhe funksionalitetit të vendeve kulturore dhe fetare, si dhe me qëllim të ruajtjes së mjedisit të tyre historik, kulturor dhe natyror, duke parandaluar çfarëdo zhvillimi negativ apo të parregullt në afërsinë e tyre dhe përreth.

Incidente, sulme dhe vandalizma kanë ndodhur në regjione të ndryshme, siç është sulmi me granatahedhës në manastirin e Deçanit në mars të vitit 2007. Ky incident është dënues menjëherë nga pushteti lokal dhe ai qendror. ShPK-ja i filloj dhe i përfundoj hetimet me zënie e fajtorit. Në Istog, pas vjedhjeve të pllakave metalike në kishë, më 1 prill 2007, kryetari i Kuvendit komunal lëshoi një komunikatë për shtyp, përmes së cilës e dënoi rastin dhe kërkoi respekt dhe tolerancë për të gjitha besimet fetare. Edhe pse në përgjithësi sulmet kundër vendeve fetare dhe kulturore në Kosovë janë më të pakta sesa viteve të mëparshme, nevoja për fuqizimin e mbrojtës së atyre vendeve mbetet prioritet. Po ashtu duhet të theksohet se kjo formë e sulmeve nuk ndodh vetëm kundër Kishës ortodokse serbe. Një numër tjerë i vendeve të besimeve të ndryshme fetare janë shënjestër për vjedhjen e pllakave të metalit dhe të artefakteve fetare. Fatkeqësisht shumica prej këtyre vendeve nuk posedojnë sisteme kundër vjedhjes, duke mbetur kështu të ekspozuara ndaj këtyre formave të krimit.



IPVQ-të kanë ndërmarrë masa të ndryshme për fuqizimin e kornizës legislative për mbrojtjen e vendeve kulturore dhe fetare. Në këtë drejtim, në maj të vitit 2007, me përkrahjen e grupit teknike, IPVQ-të themeluan Nëngrupin Punues (NP) për trashëgiminë kulturore. Qëllimi i NP-së është të identifikojë hapat e nevojshëm për zbatimin e shtojcës V të Propozimit gjithëpërfshirës të Ahtisarit<sup>17</sup>, bazuar në ligjin në fuqi në Kosovë për trashëgiminë kulturore dhe lirinë e besimit fetar. Zëvendësministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe përfaqësuesi i Zyrës Ndërkombëtare Civile (ZNC) bashkëdrejtojnë grupin, në të cilin marrin pjesë përfaqësuesit e Zyrës së Kryeministrit (ZK), Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe të palëve të tjera me interes.

Për më tepër, grupi teknik i NP-së është duke hartuar Ligjin për Themelimin e Zonave të Posaçme të Mbrojtura (LThZPM), duke i futur shumicën e dispozitave relevante nga shtojca V e Propozimit gjithëpërfshirës të Ahtisarit. Përmes këtij projektligji parashihet themelimi i të ashtuquajturave “Zona të Posaçme të Mbrojtura (ZPM)” përreth 45 vendeve fetare, të identifikuar përmes propozimit të Ahtisarit për mbrojtje të posaçme. Disa veprimtari të caktuara brenda perimetrit të ZPM-së do të jenë të ndaluara. Ndërsa, disa veprimtari të tjera mund apo mund të mos jenë të kufizuara në bazë të marrëveshjes mes pushtetit komunal dhe Kishës ortodokse serbe. Edhe pse Kisha ortodokse serbe nuk është e përfaqësuar në NP, ajo është e angazhuar në letërkëmbime me bashkëdrejtuesit e NP-së dhe ka dhënë komente pozitive për projektligjin. Një këshill për zbatim dhe monitorim parashihet që në mes të tjerash të monitorojë dhe të lehtësojë zbatimin e ligjit.

Në një aktivitet të ngjashëm, MMPH-ja ka miratuar një plan veprimi për harmonizimin e legjislacionit dhe të aktiviteteve për planifikimin hapësinor me projekt LThZPM-në. Përveç identifikimit të legjislacionit në fuqi në Kosovë që duhet të harmonizohet, MMPH-ja ka identifikuar masat për përfshirjen e ZPM-ve në planifikimin hapësinor. Në nivel qendror, MMPH-ja së bashku me Institutin për Planifikim Hapësinor janë pajtuar për procedurat që do të respektohen nga Instituti i Planifikimit Hapësinor në kuadër të Planit hapësinor të Kosovës, siç është përfshirja e ZPM-ve në hartë dhe në plane kadastrale. Në nivelin lokal, plani i veprimit parashihet përfshirjen e ZPM-ve në plane lokale, si dhe rishikimin e planeve komunale, urbanistike dhe rregullative për çdo qëllim. Më tej, në planin e veprimit parashihet aftësimi për planifikimin hapësinor dhe legjislacionin për planin hapësinor të zyrtarëve komunalë, si dhe organizimi i një fushate të vetëdijesimit që do të orientohej drejt komunitetit që banon në zonat e parapara të posaçme mbrojtëse.

ShPK-ja do të jetë përgjegjëse për sigurinë e vendeve kulturore dhe fetare. Aktualisht është duke u hartuar një urdhër standard operacional i ShPK-së me ndihmën e policisë së UNMIK-ut. Ky urdhër përcakton udhëzimet për komandantët regional, stacionet e policisë dhe njësitë lidhur me bërjen e vlerësimit të sigurisë në nivel të reagimit nda të gjitha incidentetë të sigurisë që kanë të bëjnë me vendet kulturore dhe fetare.

Në pritje të miratimit të një kornize të përshtatshme, më 12 nëntor 2007, kryeministri nënshkroi Udhëzimin Administrativ (UA) nr. 2007/11, përmes të cilit përkohësisht

---

<sup>17</sup> Shtojca V, Trashëgimia fetare dhe kulturore

ndalohej ndërtimi në ZPM-të e parapara. Në këtë Udhëzim ceken disa vende që caktohen si ZPM të përfshira në shtojcën V të Propozimit të Ahtisarit. Një numër i aktiviteteve po ashtu janë të ndaluara, duke përfshirë ndërtimet komerciale, siç janë ndërtesat më të larta se objekti; ndërtimi i rrugëve, i depove, i tregjeve, restoranteve, etj. Është pranuar se ekziston një vakuum ligjor, pasi që UA nuk përfshinë masat ndëshkuese në rast të shkeljes së dispozitave apo nuk parasheh rregulla që vlejné për ndërtimet që tanimë kanë filluar në ZPM. Nuk dihet nëse do të miratohet ndonjë masë legjislative për të siguruar kompensimin dhe kërkesat e tjera pronësore të pronarëve që janë të prekur nga kufizimet në shfrytëzimin e pronës të paraparë në ZPM.

Një zhvillim pozitiv paraqet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/52 për shpalljen e Ligjit për Trashëgiminë Kulturore<sup>18</sup> (LTK). Përmes këtij Ligji tentohet të rregullohet fushëveprimi i trashëgimisë kulturore lidhur me ruajtjen, mbrojtjen, qasjen publike, komunikimin dhe ofrimin e burimeve të nevojshme në mënyrë që trashëgimia të gëzohet si një monument historik dhe kulturor (neni 1.4). Në përputhje me ligjin, pushteti komunal dhe ai qendror është i obliguar të ruajë, të mbrojë dhe të konservojë të gjitha vendet e trashëgimisë kulturore me vlerë historike dhe kulturore, duke përfshirë trashëgiminë fetare.

Më 24 gusht 2006, hyri në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/48 për shpalljen e Ligjit për lirinë e besimit fetar në Kosovë<sup>19</sup>. Me ligjin e miratuar për lirinë e besimit fetar, Kosova ka krijuar një platformë për kultivimin e klimës së tolerancës dhe respektit të ndërsjellë mes besimtarëve nga komunitetet e ndryshme, si dhe mes besimtarëve dhe jobesimtarëve. Ky Ligj ngërthen të gjitha standardet ndërkombëtare për lirinë e besimit fetar dhe përkrah vlerat e neutralitetit fetar dhe mëvetësisë fetare, duke paraparë njohjen themelore të të drejtave pronësore dhe të posedimit të komuniteteve fetare lidhur me vendet e tyre të kultit (neni 8.1 dhe 12.3), si dhe mbrojtjen kundër veprave kriminale (neni 4.2). Ligji për lirinë e besimit fetar nuk përmend mbrojtjen aktive të vendeve fetare, siç është themelimi i zonave të mbrojtura, vendeve të mbrojtura, konservimin, restaurimin dhe mbrojtjen, siç është korniza ligjore e paraparë në Ligjin për trashëgiminë kulturore. Megjithatë, shpallja e paraparë e projektligjit për themelimin e zonave të posaçme të mbrojtura do të mundësojë sigurinë dhe funksionimin e të gjitha vendeve fetare, si dhe ruajtjen e mjedisit të tyre natyror dhe historik, duke parandaluar çfarëdo aktiviteti negativ në afërsinë e tyre apo përreth tyre.

#### *Rindërtimi i vendeve të dëmtuara*

Procesi i rindërtimit të vendeve të dëmtuara gjatë trazirave të vitit 2004 ka shënuar përparime në vitin 2005. Në mars të vitit 2004, janë dëmtuar 34 vende ortodokse serbe. IPVQ-të kanë ndarë 4 milionë euro për procesin e rindërtimit, dhe 2 milionë të tjera janë dhënë nga Agjencia Evropiane për Rindërtim. Një Komision shumëpalësh për Zbatimin e Rindërtimit (KZR) ka kryer punët me sukses në shtatë vende prioritare, dhe ka ndërhyrë në të gjitha vendet fetare për të parandaluar shkatërrimin e mëtejshëm. Procesi i tenderimit

<sup>18</sup> Ligji nr. 02/L-88, i shpallur nga Kuvendi i Kosovës.

<sup>19</sup> Ligji në 02/l-31, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

është në vazhdim e sipër për përfundimin e rindërtimit në vendet e mbetura. Të gjitha punët parashihen të kryhen deri në fund të vitit 2008.

Në vitin 2005, KZR-ja ka zbatuar masat e mbrojtjes në 31 vende nga 34 sosh. Vendet janë mbrojtur kundër shkatërrimit të mëtejshëm, duke krijuar kështu kushtet për aktivitete të tjera. KZR-ja ka përfunduar riparimet në shtatë vende më të vogla apo më pak të dëmtuara.

Në vitin 2006, KZR-ja ka kryer rindërtimet e shumta për shtatë vendet prioritare. Rindërtimet më të mëdha u bënë në kishën episkopike të Shën Gjorgjes në Prizren dhe në kishën e Shën Nikollës në Prishtinë. Përveç kësaj, është ndërtuar muri rrethues në vendin plotësisht të shkatërruar të kishës së vjetër në Gjakovë.

Në vitin 2007, KZR-ja ka tenderuar punët e tjera të rindërtimit në 12 vende (punët aktualisht po zhvillohen në shtatë prej tyre), të cilat duhet të kryhen mes fundit të vitit dhe pranverës së vitit 2008. KZR-ja po ashtu është duke i bërë punët përgatitore për rindërtimin/restaurimin e elementeve dekorative (muralet, ikonostasin, ikonat), të cilat janë të programuara të zbatohen gjatë vitit 2008.

Përveç rindërtimit, KZR-ja ka kontribuar në krijimin e bashkëpunimit të efektshëm dhe të strukturës së përbashkët vendimmarrëse mes autoriteteve fetare, qeverisë vendore dhe bashkësisë ndërkombëtare. Aktivitetet e tjera kanë ngërthyer fushatat e vetëdijesimit për vlerat e llojllojshmërisë kulturore që janë zbatuar së bashku me qeverinë. Njëkohësisht me punët e rindërtimit është zhvilluar komponenti i ngritjes së kapaciteteve në dobi të institucioneve vendore, universiteteve, ekspertëve dhe kontraktuesve. Kjo është bërë përmes organizmit të punëtorive dhe ligjëratarave nga ekspertët ndërkombëtarë, vizitave nëpër vende, këmbimit të përvojave dhe përhapjes së rezultateve dhe aktiviteteve të KZR-së.

**Rekomandimi nr. 14 i Këshillit të Evropës. *Rritja e masave për përkrahjen e kulturave të komuniteteve pakicë, duke përfshirë edhe ato numerikisht më të vogla, dhe sigurimi i pjesëmarrjes së personave që u përkasin pakicave në procesin relevant të vendimmarrjes.***

Më 18 gusht 2006 hyri në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/44 për shpalljen e Ligjit për institucionet e kulturës<sup>20</sup>. Përmes këtij Ligji mbrohen dhe avancohen institucionet e të gjitha komuniteteve. Pasi të jenë regjistruar dhe pasi të punojnë në përputhje me ligjin, institucionet kulturore kanë të drejtë të marrin fonde nga buxheti i konsoliduar i Kosovës.

**Rekomandimi nr. 15 i Këshillit të Evropës. *Të përpunohen shpejtë aplikacionet e vonuara për licenca televizive dhe të radios, me qëllim të zgjerimit të fushëveprimt dhe llojllojshmërisë së transmetimeve për komunitetet pakica dhe nga to, si dhe të ndërmerren hapa të mëtejshëm për tu siguruar që të gjitha komunitetet të kenë qasje të barabartë në shërbimin e transmetimit publik***

---

<sup>20</sup> Ligji nr. 02/L-57, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Vendimet për aplikacionet për licenca janë përfunduar nga Komisioneri i Përkohshëm për Media (KPM) në vitin 2006. Po kështu, Bordi i medieve për ankesa, i themeluar sipas trashëgimitarit ligjor të KPM-së - Komisionit të Pavarur për Media (KPM) <sup>21</sup> e rishqyrtuan vendimin lidhur me aplikacionin e goranëve në Kosovën jugore. Kjo çojë në themelimin e një stacioni shtesë goran. KPM-ja nuk ka dhënë ndonjë licencë tjetër apo nuk i ka ndryshuar ato ekzistueset për stacionet ekzistuese.

Kosova tani për tani ka 114 stacione të licencuara radio dhe televizive. Shtatë prej tyre (tri televizive dhe katër radiostacione) kanë licenca për transmetim në mbarë Kosovën. Stacionet e tjera transmetojnë në nivel lokal apo regjional. Në bazë të KPM-së, 35 nga këto stacione transmetojnë kryesisht në gjuhën serbe, tri në gjuhën boshnjake, dy në atë gorane, tri në gjuhën turke dhe një në atë rome. Dy stacione nuk kanë ndonjë gjuhë kryesore të transmetimit, dhe transmetojnë në mënyrë të barabartë si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë serbe (me disa programe edhe në gjuhën rome). Tridhjetë e katër stacione transmetojnë programe në më shumë se një gjuhë, përveç gjuhës së tyre kryesore.

KPM-ja ka filluar zhvillimin e procesit për rilicencimin gjithëpërfshirës të tërë spektrit të frekuencave të transmetimit në Kosovë, i cili pritet të fillojë gjatë vitit 2008.

Politika formale e transmetimit e miratuar nga KPM-ja, përfshinë dispozitat, përmes të cilave shprehimisht kërkohet llojllojshmëria kulturore dhe gjuhësore, dialogu ndërkomunitar dhe qasja nga komunitetet pakica në transmetim në gjuhë e tyre përkatëse.

KPM-ja ka vendosur të mos lëshojë licenca të reja para rilicencimit gjithëpërfshirës. Megjithatë, Këshilli i KPM-së bëri një përjashtim në shkurt të vitit 2007 me qëllim të hapjes së tenderit për radiostacionin e parë që do të transmetonte vetëm në gjuhën rome. Pas një vonesë për shkak të ankesës së një aplikuesi që nuk kishte marrë licencën (ankesa u hodh poshtë nga Bordi i medieve për ankesa), aplikuesi i suksesshëm morri licencën në gusht të vitit 2007, dhe pritet të fillojë transmetimin deri në fund të vitit.

Gjatë vitit 2007, Këshilli i KPM-së miratojë një rregullore që përcaktonte nivelin e pagesës për licenca të transmetuesve. Përmes rregullores ofroheshin lirime për transmetuesit që u shërbejnë komuniteteve pakica, mirëpo disa transmetues parashtuan ankesë sepse mendon se ky lirim nuk ishte i mjaftueshëm. Si përgjigje ndaj ankesës, në tetor të vitit 2007 Bordi i medieve për ankesa lëshoi një vendim, përmes të cilit udhëzohet KPM-ja për ta rishikuar modelin e pagesës për licencë.

Gjatë vitit 2007, KPM-ja gjithashtu filloj rregullimin e transmetimit kabllor në Kosovë. Rregulloret e reja kishin dispozitat që ofronin stimulime për operatorët kabllorë që do të ofronin 20% të kanaleve të veta në gjuhët e pakicave.

---

<sup>21</sup> Komisioni i Pavarur për Media (KPM) është themeluar më 28 gusht 2006, pasardhësi i Komisionerit të Përkohshëm për Media (KPM). Komisioni i pavarur për media përbëhet prej zyrës së KPM-së (të udhëhequr nga shefi ekzekutiv), këshilli shtatanëtarësh (pesë anëtarë të përhershëm dhe dy anëtarë ndërkombëtarë), dhe nga Bordi i medieve për ankesa - dora përfundimtare ekzekutive e rregullatorit (një kryesues ndërkombëtar dhe dy gykatës të Kosovës).

Si transmetues publik, RTK-ja me një kanal televiziv dhe me dy kanale të radios, ka obligim ligjor të transmetojë 15% të kohës programore në gjuhë joshqiptare. Në bazë të RTK-së, përqindja e programeve të prodhuara nga RTK-ja në gjuhët e pakicave në televizion është 16.4% dhe të atyre të radios është 18%. Pas monitorimit nga KPM-ja doli se vetëm 9.8% e kohës së përgjithshme programore të RTK-së është në gjuhën e pakicave.

RTK-ja aktualisht mbulon rreth 75% të vendeve të banuara të Kosovës. Sipas ligjit, transmetuesi është i obliguar ta rrisë këtë mbulueshmëri në 90%, duke përfshirë 90% të vendeve ku jetojnë komunitetet pakicë. Për të ngushtuar këtë zbrazëti ligjore, që nga shtatori i vitit 2006, RTK-ja është duke transmetuar programet e veta në gjuhët e pakicave në plotëni përmes kanalit të tij satelitor. Vlerësohet se rreth 90% e kosovarëve mund të shohin programin e pakoduar satelitor të RTK-së. Përderisa programi për pakica është i njëjtë si në kanal in tokësor, ashtu edhe në atë satelitor, e njëjta nuk vlen për programet në gjuhën shqipe për shkak të rregullimeve të të drejtave të autorit, të cilat ia ndalojnë RTK-së transmetimin e ngjarjeve sportive apo të filmave përmes kanalit satelitor. Për t'i mbuluar edhe ata 10% që nuk janë të mbuluar as nga rrjeti tokësor e as nga ai satelitor, RTK-ja ka propozuar t'i blejë pranuesit satelitorë për atë pjesë të popullatës, por deri më tani nuk ka filluar ta bëjë një gjë të tillë.

Në nivel lokal, ende ka ankesa nga banorët në vendet kodrinore-malore dhe në ato dobët të mbuluara nga sinjali tokësor për qasje të kufizuar në informata. Përveç problemeve në pranimin e sinjalit të RTK-së në disa vende, numri i informatave të dhëna nga transmetuesit lokalë po bie, ndërsa disa stacione lokale që transmetonin programe për komunitete joshqiptare është dashur t'i heqin programet e tyre informative për shkak të kufizimeve financiare.

Një fakt tjetër brengosës lidhur me qëndrueshmërinë e stacioneve të pakicave është se KEK-u këtë vit ua ka dërguar faturat e rrymës disa stacioneve të pakicave, të cilat fatura mbulonin harxhimin e rrymës për vitet e kaluara. Si shembull për këtë është se një stacioni medial i është kërkuar të paguajë faturën e rrymës në shumë prej 24.650.89 euro. Nëse KEK-u vendos që këto fatura patjetër të paguhen pa u ofruar stacioneve një plan për pagesë afatgjatë, mund që seriozisht të rrezikojë stacionet e pakicave dhe stacionet mediale me një audiencë të vogël.

E ardhmja financiare e RTK-së po ashtu është e pasigurt. RTK-ja është kryesisht e financuar përmes parapagimit për transmetuesin publik në shumë prej 3.50 euro në muaj për një amvisëri. Parapagimi për transmetuesin publik arkëtohet nga KEK-u në bazë të kontratës së shërbimit mes RTK-së dhe KEK-ut. Më 3 gusht 2007, KEK-u njoftoi RTK-në se do të përfundojë kontratën e shërbimit, duke filluar nga 3 shkurti 2008. Një mekanizëm tjetër i arkëtimit apo metodë e financimit nuk duket në horizont, dhe do të ketë nevojë për përpjekje të përbashkëta mes IPVQ-ve, Kuvendit të Kosovës dhe RTK-së për gjetjen e zgjidhjes. Mund të pritët që zvogëlimi substancial i këtij buxheti do të ketë po kështu ndikim në cilësinë e programeve për pakicat.

Edhe fondi për përkrahjen e medieve të pakicave, të atyre shumetnike dhe për personat me aftësi të kufizuara që është themeluar brenda Zyrës së kryeministrit, është gjithashtu i prekur nga përfundimi i kontratës për shërbim me KEK-un. Sipas ligjit në fuqi, ky fond financohet nga pesë përqindëshi i parapagimit për transmetuesin publik, dhe shuma e tij deri në fund të vitit 2007 duhet të jetë mbi 650.000 euro. Megjithatë, KEK- deri më sot nuk ka deponuar asnjë shumë të hollash në këtë fond, dhe e ardhja e tij është e kërcënuar nëse KEK-u ndalon arkëtimin e parapagimit për transmetuesin publik.

## **Përdorimi i gjuhëve**

***Rekomandimi nr. 16 i Këshillit të Evropës. Të miratohet legjislatura e re për gjuhë me qëllim të rritjes së qartësisë dhe të sigurisë ligjore lidhur me përdorimin e gjuhëve, duke përfshirë në raport me autoritetet administrative, emërtimet topografike dhe regjistrimin e emrave personal, si dhe monitorimi nga afër i respektimit të dispozitave për gjuhën në sektorët relevantë, duke përfshirë edhe gjyqësorin.***

Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, kapitulli 4, komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë që në Kosovë të flasin gjuhën dhe të shkruajnë alfabetin e vet lirshëm. Kjo nënkupton përdorimin e lirë të gjuhës dhe të alfabetit të arsim dhe edukim, në gjykata, në agjenci qeveritare dhe në organet e tjera publike në Kosovë.

Pas një procesi të gjatë të hartimit, shpallja e Ligjit për përdorimin e gjuhëve (Ligji për gjuhët) përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/51, më datën 20 tetor 2006, ka kontribuar në harmonizimin, qartësimin dhe në rregullimin gjithëpërfshirës të përdorimit të gjuhëve nga ana e IPVQ-ve dhe e të gjitha organizatave të tjera që kryejnë shërbime dhe funksione publike.

Preambula i referohet standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të pakicave, bazuar në të cilat është hartuar Ligji për gjuhët. Dispozitat e përgjithshme, nenet 1-3, paraqesin përkufizimet, parimet dhe kushtet për njohjen e gjuhëve të caktuara dhe për të drejta gjuhësore. Dispozitat specifike, nenet 4-30, rregullojnë përdorimin e gjuhëve në institucionet qendrore, në ato komunale, në ndërmarrje publike dhe shoqërore, në procedurat gjyqësore, në arsim, në media, në sferën private, në emrat personale dhe në lirinë gjuhësore. Dispozitat për zbatim, nenet 31-33, obligojnë qeverinë e Kosovës të themelojë një mekanizëm institucional, gjegjësisht komisionin për gjuhë, përmes të cilit do të mbikëqyrej zbatimi i Ligjit, dhe do të parashiheshin sanksionet në rast të mosrespektimit të Ligjit. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare, gjegjësisht nenet 34 dhe 35 parashohin që IPVQ-të të vazhdojnë përdorimin e gjuhës angleze gjatë periudhës së administratës së UNMIK-ut, si dhe që të gjitha IPVQ-të të miratojnë rregullativë të hollësishme për përdorimin e gjuhëve në pajtim me Ligjin për gjuhët dhe aktet nënligjore të tij.

Neni 2.1 e njeh gjuhën shqipe dhe atë serbe, si dhe alfabetet e tyre, si gjuhë zyrtare në Kosovë, të cilat kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës. Në pajtim me nenet 2.3 dhe 2.4, njohja e “një gjuhe zyrtare në komunë” dhe e “gjuhë në përdorim zyrtar në

komunë” varet nga numri i popullatës që e flasin atë gjuhë, me një përjashtim të dukshëm për gjuhën turke, së cilës i është dhënë statusi i gjuhës zyrtare në komunën e Prizrenit.

Përdorimi i gjuhëve në institucionet qendrore, duke përfshirë qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës, si dhe komisionet e tij, është qartë i përcaktuar në nenin 4 dhe 5, ku ritheksohet përdorimi i gjuhëve zyrtare në mënyrë të barabartë. Këtu përfshihen obligimet vijuese të IPVQ-ve: të sigurojnë përkthimin simuluan; të përkthejnë dhe të vejnë në dosje shënimet, dokumentet zyrtare, si dhe ligjet; të vendosin emërtimet zyrtare të institucioneve publike në gjuhët zyrtare dhe, në përgjithësi, “të sigurojnë që mjedisi i punës të jetë i përshtatshëm për përdorimin e efektshëm të gjuhëve zyrtare dhe të lehtësojnë përdorimin e cilësdo gjuhë zyrtare nga zyrtarët dhe nëpunësit.” Sa u përket anëtarëve të qeverisë dhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës, gjuha e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, nenet 4.4 dhe 5.2 u japin të drejtë që ata ta flasin gjuhën e vet në mbledhjet e institucioneve qendrore dhe në mbledhjet publike të organizuara nga këto institucione.

Gjatë seancave plenare të Kuvendit të Kosovës përkthimi simultan është rregullisht në dispozicion. Sa u përket komisioneve të Kuvendit, ekzistojnë disa mangësi lidhur me funksionimin e pajisjeve dhe me disponueshmërinë e përkthyesve.

Neni 5.4 i Ligjit për gjuhët parasheh që të gjitha ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës të nxjerrën dhe botohen në gjuhët zyrtare dhe në gjuhën boshnjake e atë turke. Në prill të vitit 2006, qeveria e Kosovës ka themeluar Zyrën për menaxhimin dhe administrimin e Gazetës zyrtare të IPVQ-ve, e cila çdo muaj boton Gazetën zyrtare, të përkthyer në pesë gjuhë: shqip, serbisht, turqisht, boshnjakisht dhe anglisht.

Përdorimi i gjuhëve në institucionet komunale është i rregulluar përmes neneve 7-10 të Ligjit për gjuhët. Përveç obligimit për të siguruar përdorim të barabartë të gjuhëve zyrtare të komunës, sipas nenit 7.1, komuna është e obliguar t’u jep status të njëjtë gjuhëve të tjera të komuniteteve me kusht që të plotësohen kushtet e parapara në nenin 2.3 të Ligjit për gjuhët<sup>22</sup>. Megjithatë, në pritje të regjistrimit zyrtar të popullsisë, Prizreni është e vetmja komunë ku është njohur një gjuhë shtesë, gjegjësisht gjuha turke. Në nenin 8 përcaktohen të drejtat e personave, gjuha amtare e të cilëve është “gjuhë në përdorim zyrtar në komunë” në përputhje me nenin 2.4. Aktualisht, gjuha turke ka fituar njohje të tillë në Mitrovicë dhe në Gjilan. Komuna e Dragashit dhe ajo e Pejës e njohin gjuhën boshnjake si gjuhë zyrtare, por nuk kanë miratuar rregullore për këtë.

Neni 7 i Ligjit për përdorimin e gjuhëve qartazi parasheh që rregulloret komunave të shtypen dhe të botohen në gjuhët zyrtare të komunës. Përderisa një numër i komunave kanë bërë përpjekje të dukshme që të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, ekzistojnë po ashtu raste ku ende pritet të bëhet përkthimi i tillë. Në bazë të raportit të OSBE-së për aktivitetet legjislative në komunat e Kosovës, të botuar në gusht të vitit 2007, 17 komuna kanë deklaruar se për të përkthyer dhe botuar dokumentet zyrtare në të dy gjuhët zyrtare apo që të paraqiten informatat në të dyja gjuhët brenda dhe jashtë

---

<sup>22</sup> Neni 2.3 parasheh se nëse komuniteti përbën pesë për qind të popullatës së gjithëmbarshme të komunës ku banon, dhe gjuha amtare e të cilit nuk është zyrtare, gjuha e atij komuniteti njihet si gjuhë zyrtare e asaj komune.

ndërtesës së komunës është vështirë për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme dhe të pakënaqshme të përkthimit.

Përdorimi i gjuhëve në procedurat gjyqësore është i rregulluar përmes neneve 12-18 të Ligjit për gjuhët. Në janar të vitit 2007, raporti i OSBE-së për përkthimin dhe shkrim dhe me gojë në sistemin gjyqësor të Kosovës, përvijoi si në vijim: a) gjuha shqipe, serbe, angleze dhe, ku është e aplikueshme, edhe gjuha turke, janë gjuhë zyrtare të gjykatave në Kosovë; b) të gjitha komunitetet kanë të drejtë të përdorin lirshëm gjuhën dhe alfabetin e tyre në të gjitha komunikimet lidhur me procedurat gjyqësore; c) për të ushtruar këtë të drejtë, personat që u përkasin atyre komuniteteve kanë të drejtë për përkthim me shkrim apo me gojë falas dhe d) gjykatat janë të obliguara të botojnë mbishkrimet, lajmërimet dhe buletinet në të gjitha gjuhët zyrtare.

Emrat personalë dhe, në veçanti e drejta për të regjistruar patronimët në regjistrat publikë në gjuhën zyrtare të zgjedhur nga personi njihet sipas nenit 27.1 të Ligjit për gjuhët. Para ekzistimit të Ligjit për gjuhë, UA 2005/06 për përdorimin në origjinal të emrave personalë në dokumentet personale dhe publike (i nxjerrë nga MShP-ja) në nenin 5.1 do ta kufizonte fushëveprimin e regjistrimit të emrave vetëm në alfabetin latin. Megjithatë është konsideruar se referimi ekskluziv në alfabetin latin nuk ishte në përputhje me përdorimin e papenguar dhe statusin e barabartë të gjuhës zyrtare serbe dhe të alfabeve të saj, siç parashihet në nenin 2.1 të Ligjit për gjuhët, në bazë të të cilit “Gjuha shqipe dhe ajo serbe, si dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare të Kosovës dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës.”

Për t’i përmbushur kërkesat e komuniteteve të tjera nga ai shqiptar dhe serb i Kosovës, neni 27.2 i Ligjit për gjuhët, garanton të drejtën e komuniteteve, gjuha e të cilëve nuk është zyrtare të “shënojnë formën origjinale të emrit dhe mbiemrit të tyre sipas shkrimit në bazë të traditës dhe sistemit gjuhësor të gjuhës së tyre në regjistrat publikë, dokumentet personale të identifikimit dhe në dokumentet e tjera zyrtare.” Andaj, me ekzistimin e Ligjit për gjuhët, komunitetet kanë bazë ligjore për të kërkuar që emrat dhe mbiemrat e tyre të regjistrohen në gjuhën amtare dhe nga autoritet kërkohet të respektojnë strukturën gjuhësore dhe alfabetin e gjuhës përkatëse.

**Rekomandimi nr. 17 i Këshillit të Evropës. *Të sigurohet që miratimi i legjislativës së re për gjuhët të shkojë krah për krah me kapacitetet adekuate të zbatimit dhe që procedurat, duke përfshirë edhe ato gjyqësoret, të ekzistojnë në rast të mosrespektimit të kushteve për gjuhët, duke përfshirë rastet e çfarëdo ndryshimi joligjor të emërimit të vendeve.***

IPVQ-të kanë themeluar mekanizma qendror dhe komunal për të siguruar dhe monitoruar zbatimin e Ligjit për gjuhët dhe të legjislativës tjetër të ndërlidhur me të. Përmes Udhëzimit administrativ nr. 2007/3, Zyra e Kryeministrit (ZK) ka themeluar Komisionin qendror për gjuhët. Komisioni për gjuhët në mes të tjerash ka autoritetin për të pranuar ankesa dhe për të bërë hetime me nismë të vetën; të bëjë aktivitetet të ndërmjetësimit në situatat ku ndërmjetësimi i tillë kërkohet për të siguruar zbatimin e ligjit; të lëshojnë vërejtje me shkrim në rast të moszbatimit të rekomandimeve të tij brenda një kohe të



arsyeshme; t'ia dorëzojë raportin vjetor qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, si dhe të rishikojë dhe jap rekomandime lidhur me legjislacionin që prek apo mund të prek statusin apo përdorimin e gjuhëve zyrtare apo të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, siç parashihet në nenin 32 të Ligjit për gjuhët.

Përbërja e Komisionit për gjuhët ngërthen në vete përfaqësues të gjashtë ministrive dhe një përfaqësues të Kuvendit të Kosovës. Të gjithë anëtarët e Komisionit emërohen nga kryeministri, siç parashihet në UA. Në pajtim me nenin 32.10, Komisioni duhet të pasqyrojë llojllojshmërinë gjuhësore të komuniteteve në Kosovë.

Në kuadër të degës qendrore të ekzekutivit, Ministria e Shërbimeve Publike (MShP) monitoron zbatimin e Ligjit për gjuhët në nivel qendror përmes Njesisë së monitorimit të përdorimit të gjuhëve zyrtare në institucionet qendrore të Kosovës (Njësia qendrore për monitorimin e gjuhëve). Kjo Njësi është themeluar më 1 prill 2005 në pajtim me vendimin nr. 2005/02 të MShP-së, dhe me vonë i është dhënë edhe rregullorja e punës përmes UA të MShP-së nr. 2006/10 për rregullat dhe procedurat e punës të njësisë për monitorim të përdorimit të gjuhëve zyrtare në institucionet qendrore në Kosovë, i cili hyri në fuqi më 1 shtator 2006. Njësia qendrore për monitorimin e gjuhëve monitoron respektimin nga ana e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore të legjislaturës në fuqi për gjuhët. Kjo përfshinë edhe themelimin e njësive të përkthimit nëpër ministri, disponueshmërinë e pajisjeve për përkthim simultan dhe ofrimin e shërbimeve të kërkuara të përkthimit në çdo ministri. Në këtë drejtim, Njësia qendrore për monitorimin e gjuhëve mban statistikën mujore për shërbimet e përkthimit dhe për dokumentet e përkthyer nga ministritë dhe nga institucionet e tjera qendrore, si dhe raportin për përparimin e arritur dhe vërteton parregullsitë. Në UA paraqiten formularët standard për përdorim nga njësitet e përkthimit, duke përfshirë formularin e kërkesës për përkthim me shkrim dhe formularin e kërkesës për përkthim simultan. Udhëheqësit e njësive të përkthimit që gjenden në institucionet qendrore janë të obliguar të përdorin formularët e përshkruar dhe t'ia dorëzojnë raportin mujor Njesisë qendrore për monitorimin e gjuhëve.

UA përmban dispozitat e hollësishme për aftësi dhe zhvillim profesional të përkthyesve. Në veçanti, Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP), në mesin e aktiviteteve të tjera, është gjithashtu përgjegjës të organizojë kurse të aftësimeve për zhvillimin e kapaciteteve të përkthyesve të punësuar në IPVQ-të qendrore dhe në ato komunale. Në këtë drejtim, Njësia qendrore për monitorimin e gjuhëve në bashkëpunim me IKAP-in janë përgjegjës për të identifikuar nevojat specifike të aftësimeve të njësive qendrore të përkthimit.

Në bazë të Njesisë qendrore për monitorimin e gjuhëve<sup>23</sup>, të gjitha ministritë e IPVQ-ve kanë themeluar celulat e përkthimit.<sup>24</sup> Kapacitetet e tanishme të përkthimit me gojë dhe me shkrim përbëhet prej gjithsej 68 përkthyesve – 30 përkthyes për gjuhën shqipe-serbe-shqipe dhe 38 përkthyes për gjuhën shqipe-angleze-shqipe. Po ashtu, janë të punësuar

---

<sup>23</sup> Ministria e Shërbimeve Publike, Njësia Qendrore për Monitorimin e Gjuhëve, Raporti vjetor 2006.

<sup>24</sup> Shin shtojcën 1.

edhe pesë lektorë që bëjnë lekturimin dhe kontrollin e përputhshmërisë gramatikore e sintaksore të të gjitha dokumenteve në gjuhën shqipe.

IPVQ-të janë duke i zhvilluar kapacitetet e tyre për të vlerësuar nevojat për aftësi dhe për të ofruar zhvillime profesionale. Në veçanti, përkthyesit i nënshtrohen testit të gjuhës çdo katër muaj, dhe ato rezultate përdoren për përpilimin e kurseve për ngritjen e kapaciteteve. Veçanërisht, në vitin 2007 MShP-ja dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në bashkëpunim me KIPA-n kanë organizuar aftësi për teknika të përkthimit me gojë, i cili u fokusua në të gjithë përkthyesit në nivel qendror dhe në shumicën e përkthyesve që punojnë në nivel komunal.

Në vitin 2008 qeveria e Kosovës dhe IKAP-i planifikojnë të përpilojnë dhe të organizojnë një aftësim gjithëpërfshirës të trajnerëve për tre trajnerë të gjuhës të IKAP-it, të cilët më pastaj rregullisht do të zhvillojnë programe të aftësimit për celulat qendrore dhe komunale të përkthimit. Njëkohësisht ekziston nevoja për aftësi të avancuara gjuhësore, duke përfshirë ato për terminologjinë ligjore dhe administrativet përdorur nga IPVQ-të. Në këtë drejtim, mes shkurtit dhe qershorit të vitit 2007, Këshilli i Evropës ka organizuar aftësim intensiv të gjuhës angleze për IPVQ-të.

Në kuadër të degës qendrore të ekzekutivit të IPVQ-ve, MAPL-ja ka themeluar një mekanizëm për të monitoruar përputhshmërinë me ligjin në fuqi lidhur me përdorimin e gjuhëve nga autoritetet komunale. Njësia për burime njerëzore dhe MAPL-ja kanë Sektorin për Përfshirjen e Pakicave dhe Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare (SPPPGjZ), i cili çdo muaj grumbullon nga komunat statistikat mujore për numrin e dokumenteve të përkthyer. Ato statistika ndahen sipas numrit të gjithëmbarsëm të dokumenteve të miratuara nga kuvendi komunal<sup>25</sup>, komisionet e tij<sup>26</sup>, kryeshefi ekzekutiv<sup>27</sup> dhe departamentet komunale<sup>28</sup>, si dhe bartin informata lidhur me numrin e kërkesave për përkthim dhe me numrin e dokumenteve dhe faqeve të përkthyer. SPPPGjZ gjithashtu mban statistika lidhur me punonjësit e njësive komunale të përkthimit. Përcjellja dhe identifikimi i çështjeve dhe pengesave në përdorimin e gjuhëve bëhet kryesisht përmes qasjes statistikore. SPPPGjZ-ja në bashkëpunim me MShP-në dhe IKAP-in po ashtu është i përfshirë në aktivitetet e aftësimit në nivelin qendror, të cilat kanë për qëllim të rifuqizojnë kapacitetet e celulave komunale të përkthimit.

Departamenti i administratës civile i UNMIK-ut dhe OSBE-ja kanë grumbulluar informatat për kapacitetet e përkthimit me shkrim dhe me gojë nëpër komuna (shtojca II). Që nga prilli i vitit 2007, 24 komuna nga gjithsej 34 komuna dhe Njësi Komunale Pilot (NjKP) kishin themeluar njësine të përkthimit. Numri i tanishëm i përkthyesve të punësuar nga 33 autoritete komunale të cekura është 1.6 për një komunë. Celula e përkthimit në 3-4 komuna ka deri në 3-4 përkthyes. Për më tepër, 24 (73%) komuna kanë caktuar një person kontaktues për gjuhë, që paraqet një burim të dobishëm për

---

<sup>25</sup> Rregulloret, vendimet, procesverbalet dhe dokumentet e tjera të shkruara.

<sup>26</sup> Konkludimet dhe propozimet.

<sup>27</sup> Procesverbalet.

<sup>28</sup> Vendimet.

bashkërendimin e nismave dhe politikave komunale për përdorimin e gjuhëve apo për trajtimin e problemeve të zbatimit që dalin gjatë punës së institucioneve komunale.

Formimi i celulave të përkthimit në kuadër të gjitha komunave, duke përfshirë NjKP-në e Mamushës është një veprim i nevojshëm për një mjedis shumëgjuhësor të Kosovës, veçanërisht në gjashtë komuna me tri gjuhë zyrtare. Në komunën Prishtinës dhe në atë të Vushtrrisë, komuniteti turk i ka dërguar kërkesë kuvendeve përkatëse komunale që gjuha turke të fitojë statusin e gjuhës zyrtare në ato komuna. Vendimi për këtë ende nuk është marrë. Tani për tani, një përkthyes për gjuhën turke ende nuk është punësuar në komunën e Gjilanit dhe në atë Mitrovicës. Qeveria e Kosovës inkurajon autoritetet relevante komunale që ta trajton këtë çështje dhe që të ndajnë resurse të adekuate për të siguruar arritjen e këtij objekti. Kjo vlen gjithashtu edhe për komunën e Mamushës, ku përkthyesi i punësuar është tepër i ngarkuar me punë të përkthimit me shkrim dhe me gojë prej gjuhës turke në gjuhët e tjera zyrtare.

Sa i përket disponueshmërisë së pajisjeve për përkthim simultan 20 (60.6%) komuna i ka instaluar pajisjet. Në 7 (21.2%) raste, kërkesat për ato pajisje nuk përputhen me nevojën sepse në to nuk ka fare komunitete pakicë apo numri i tyre është i vogël ose në atë komunë nuk ka të kthyer. Gjashtë (18.2%) komuna ende pritet të instalojnë pajisjet e përkthimit.

Në bazë të nenit 7.3 të Ligjit për gjuhët, pas kërkesës, institucionet komunale janë të obliguara të vejnë përkthimin në dispozicion nga një gjuhë e komunës në tjetrën gjatë takimeve të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të komunës, si dhe në mbledhje publike, të organizuara nga komuna. Përderisa 15 (46%) komuna ofrojnë rregullisht përkthim të tillë, në 12 (36%) komuna të tjera, ky përkthim bëhet me kërkesë. Në tri komuna të Kosovës të banuara me shumicë serbe që gjenden në veri të lumit Ibër, UNMIK-u ofron përkthimin prej gjuhës serbe në atë shqipe kur kjo gjë kërkohet. Në gjashtë (18%) komuna nuk ka përkthim.

Kufizimi i shpenzimeve publike në Kosovë, siç është kërkuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, dhe rezultati i zvogëlimit të limiteve buxhetore, ka pasur si rrjedhojë kufizimin e shpenzimeve komunale. Megjithatë, shumica e ministrive të IPVQ-ve janë të përkushtuara që të sigurojnë, siç është theksuar në matricat e krijuara nga Njësia e burimeve njerëzore për zbatimin e FCNM-së, se ndarja buxhetore e resurseve do të merr parasysh nevojën për pjesëmarrje të efektshme të komuniteteve pakicë në menaxhimin e pushtetit lokal.

#### *Aktet nënligjore të pushtetit qendror*

Zbatimi i Ligjit për gjuhët kushtëzohet nga miratimi i udhëzimeve administrative nga ministrinë e ndryshme të IPVQ-ve.<sup>29</sup> Përveç nëse sipas dispozitave të caktuara kërkohet një afat më i shkurtër, siç është saktësuar në tabelën e bashkëngjitur, shtojca III, në përputhje me nenin 36 të Ligjit për gjuhët, IPVQ-të janë të obliguara të miratojnë instrumente të tilla brenda gjashtë muajve nga shpallja (20 tetor 2006), gjegjësisht, deri më 28 prill 2007. Që nga shtatori 2007, IPVQ-të kanë miratuar shtatë nga nëntë aktet nënligjore. Përveç këtyre udhëzimeve specifike administrative, në bazë të nenit 35 të

---

<sup>29</sup> Shih shtojcën III.

Ligjit për gjuhët, në aktet e tyre nënligjore, IPVQ-të janë të obliguara të miratojnë rregullativë të hollësishme lidhur me përdorimin e gjuhëve në përpunje me Ligjin për gjuhët. Bazuar në nenin 36.1, qeveria e Kosovës po ashtu ka obligimin që të zbatojë një program të vetëdijesimit publik menjëherë pas shpalljes së ligjit. Ky program ende nuk është zhvilluar dhe shpërndarë.

MAPL-ja ka miratuar Udhëzimin Administrativ (UA) nr. 2007/06 për përcaktimin e procedurave lidhur me zbatimin e Ligjit për gjuhët. Përmes këtij UA-je caktohen procedurat për: a) njohjen e gjuhëve në përdorim zyrtar në nivel komunal në pajtim me nenin 2.4 të Ligjit për gjuhët; b) dorëzimin e kërkesave nga pjesëtarët e komuniteteve, gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar. Përmes këtij UA-je jepen udhëzimet për komunat lidhur me zbatimin e procedurave që do t'u mundësojnë atyre njohjen e gjuhëve zyrtare (komunitetet, përqindja e të cilëve në popullatën e gjithëmbarshme në komunë është 5% apo më shumë) dhe gjuhët në përdorim zyrtar (komunitetet, përqindja e të cilëve në popullatën e gjithëmbarshme në komunë është prej 3% e deri në më pak se 5%). Po ashtu, i udhëzon ata në procesin e njohjes së gjuhëve që tradicionalisht janë konsideruar si gjuhë në përdorim zyrtar, përmes kuvendeve përkatëse komunale.

Më 11 prill të vitit 2007, MShP-ja ka miratuar UA-në nr. 2007/1 mbi përcaktimin e sanksioneve administrative lidhur me shkeljen e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Bazuar në nenin 1 të UA-së, qëllimi i UA-së është që të përcaktojë sanksionet administrative që do të zbatohen kundër IPVQ-ve në rast të shkeljeve të Ligjit për gjuhët.

Lidhur me njohjen e gjuhëve tradicionalisht të folura në territorin e tyre, në pajtim me nenin 2.4 (pjesa e fundit) e Ligjit për gjuhët, komunat obligohen të miratojnë "rregulla të hollësishme" brenda gjashtë muajsh nga shpallja e Ligjit. Afati i këtij obligimi ka kaluar 180 ditë pas shpalljes së Ligjit (20 tetor 2006), gjegjësisht më 19 prill 2007. Kjo dispozitë mbetet e pazbatuar në shumicën e komunave. Megjithatë pritet që pas miratimit të Udhëzimit administrativ nr. 2007/6 nga MAPL-ja, komunat të marrin udhëzime për të siguruar në mënyrë të efektshme miratimin e këtyre rregullave të hollësishme komunale.

***Rekomandimi nr. 18 i Këshillit të Evropës. Të sigurohet arritja e rezultateve të prekshme në përpjekjet për dhënien fund të pasigurisë së përjetuar nga serbët, romët dhe personat që u përkasin disa komuniteteve të tjera të caktuara, gjë që i parandalon ata nga folja e gjuhës së tyre në vende publike.***

Pjesëtarët e komuniteteve pakicë i plotësojnë nevojat e tyre jetësore në komunat ku jetojnë. Liria e të folurit të gjuhës së tyre amtare në vendet publike, siç janë rrugët, shitoret, tregjet, restaurantet dhe kafeteritë është kryesisht një çështje që ka të bëjë me sigurinë dhe lirinë e lëvizjes drejt vendeve të banuara me popullatë shumicë dhe brenda tyre, qoftë në komunitetin shqiptar të Kosovës – në pjesën më të madhe të territorit apo në komunitetin e serbëve të Kosovës – veçanërisht në komunat në veri të lumit Ibër ose edhe në enklavat serbe në jug të Kosovës. Së dyti, por jo më pak e rëndësishme, kjo është një çështje e ndërveprimit dhe e komunikimit mes anëtarëve të komunitetit shumicë dhe të atij pakicë. Derisa kthimet në vendet urbane vazhdojnë të mbesin sfidë, në disa

komuna zbatimi gradual i projekteve për kthime në vendet urbane ka përkuar me kushte të përmirësuara për përdorimin e gjuhëve të komuniteteve pakica.

Komisioni këshillëdhënës i FCNM-së dhe Komisioni i Ministrave i Këshillit të Evropës me të drejtë kanë shënuar shqetësimet e shprehura nga disa komunitete pakicë lidhur me pamundësinë e tyre që të flasin gjuhën amtare në vendet publike. Gjendja në një numër komunash ka shënuar përmirësime të dukshme nga ngjarjet e marsit 2004, ku autoritetet lokale kanë krijuar praktika të mira, posaçërisht në komunat ku projektet e kthimit në vendet urbane po zbatohen në mënyrë të suksesshme. Tutje, përpjekjet e IPVQ-ve për avancimin e komunikimit ndërkomunitar, të mësuarit e të dy gjuhëve zyrtare në sistemin shkollor dhe perspektiva afatgjatë që pjesëtarët e të gjitha komuniteteve të vijojnë mësimin jo vetëm në gjuhën primare zyrtare të zgjedhur, por edhe në gjuhën tjetër zyrtare, do të përmirësojë përdorimin e gjuhëve të komuniteteve në vendet publike. Kjo është në veçanti e rëndësishme nëse dëshirojmë që mundësia e ndërveprimit gjuhësor dhe komunikimit mes gjitha komuniteteve dhe në veçanti, mes brezave më të ri, të sigurohet dhe të avancohet. Në bazë të komenteve të OSBE-së, aftësia praktike dhe vetëbesimi i pjesëtarëve të komuniteteve pakicë për të folur gjuhën e tyre amtare në vendet publike dhe masat konkrete të miratuara nga autoritete publike për avancimin e rezultateve të tilla dallojnë varësisht prej regjioneve dhe komunave.

Në rajonin e Pejës, komunat kanë ndërmarrë një numër nismash pozitive për të avancuar përdorimin e lirshëm të gjuhëve në vende publike. Përmes vendimit të Kuvendit komunal të Pejës është njohur gjuha boshnjake si gjuhë zyrtare e komunës, dhe praktikrat, siç është vendosja e të gjitha emërtimeve të rrugëve në gjuhën shqipe, serbe dhe boshnjake kanë kontribuar në avancimin e klimës së tolerancës në rritje drejt komuniteteve pakica dhe gjuhëve të tyre.

Komuna e Klinës ka krijuar praktika të mira dhe shumë të rëndësishme. Që nga marsi i vitit 2004 janë zbatuar projekte të suksesshme të kthimit në fshatrat Videjë, Dresnik dhe Klinavc. Në vitet e para të pasluftës, kthimi i serbëve të Kosovës në qytet ku disa shqiptarë të Kosovës konsideroheshin si të zhdukur është konsideruar si i paqëndrueshëm. Në fazën e hershme të procesit të kthimit në komunën e Klinës, të folurit e hapur në vende publike i gjuhës serbe vazhdojë të jetë sfidë. Megjithatë, emërimi i një të kthyeri serb të Kosovës si udhëheqës i zyrës komunale të komuniteteve në mars të vitit 2004, dhe numri në rritje i të kthyerve në vendet rurale, kanë kontribuar në ndryshimin gradual të qëndrimit të administratës komunale drejt përdorimit të gjuhës serbe.

Në Gjilan, një numër i serbëve dhe romëve të Kosovës e vizituan tregun afër kishës ortodokse në rrugën drejt Prishtinës. Shumica e tyre transportohen përmes autobusëve humanitarë të IPVQ-ve nga fshatrat përreth. Serbët dhe romët e Kosovës në përgjithësi nuk frekuentojnë kafeteritë dhe restaurantet, përveç ndoshta ato që gjenden përgjatë rrugës së lartpërmendur, dhe vetëm atëherë kur janë të pranishëm një numër më i madh i komunitetit pakicë. Që nga ngjarjet marsit 2004, si serbët, ashtu edhe romët e Kosovës vazhdojnë të jenë ngurrues të flasin hapur në vendet publike. Siç është vërejtur nga OSBE-ja, në përgjithësi ata flasin me zë të ulët gjatë takimeve të tyre me pjesëtarët e tjerë

të komunitetit të tyre në vendet ku shumica janë shqiptarë, dhe përpiqen të mbajnë në minimum diskutimet e tyre me komunitetin e shqiptarëve në gjuhën serbe (pyetjet, taksitë, etj). Serbët dhe romët e Kosovës po ashtu ballafaqohen me probleme për tu kuptuar pasi që një numër gjithnjë në rritje i popullatës së shqiptarëve nuk e flet gjuhën serbe. Aty ku është e mundur, serbët kanë tendencë t'iu qasen vendeve në dukje neutrale, duke përfshirë bankat ndërkombëtare (Pro Credit dhe Raiffesien), supermarketet e mëdha dhe shitoret në rrugët kryesore, afër ndërtesës së komunës, në stacion të Shërbimit Policor të Kosovës dhe në shitore afër qendrës. Pjesëtarët e komunitetit rom duket të jenë pak më të rehatshëm në vendet me shumicë shqiptare, dhe reagimi ndaj pranisë së tyre dallon shumë nga ai për serbët e Kosovës.

Në komunën e Kamenicës, pushteti komunal është duke kontribuar në krijimin dhe ruajtjen e mjedisit dygjuhësor serb dhe shqiptar. Komuna përkrah në mënyrë aktive mjedisin stimulues për përdorimin e lirshëm të gjuhës në vendet publike, posaçërisht përmes nismave shumëgjuhësore të informimit. Këto masa përkrahëse përfshijnë: dhënia e fletushkave shumëgjuhësore qytetarëve lidhur me qasjen në shërbime komunale, fushatat shumëgjuhësore të vetëdijesimit për shërbimet komunale dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve lidhur me radiostacionet lokale, një dërrasë për lajmërimet publike me informata të bollshme në të dy gjuhët zyrtare lidhur me vendet e lira të punës, informatat për mbledhjet publike dhe të kuvendit komunal, si dhe për rregullat komunale për diskutimet publike.

Në mesin e shumicës serbe të komunës së Shtërpçës, ndërveprimi mes shumicës dhe komunitetit shqiptar që gjendet në vendet e caktuara mbetet minimal. Banorët serbë kryesisht nuk shkojnë në fshatrat shqiptare në lindje të punktimit kontrollues të KFOR-it në fshatin Drekok. Sa i përket komunitetit shqiptar, ata mund të flasin lirshëm gjuhën e tyre përmes komunës së Shtërpçës. Në shitore, kafeteri, restaurante dhe në vendet me shumicë serbe, shqiptarët kryesisht komunikojnë me stafin në gjuhën serbe.

Pas ngjarjeve të marsit 2004, komuniteti serb dhe ai rom në Viti gradualisht kanë treguar vetëbesim që ta flasin gjuhën e tyre lirshëm në shitore, në tregje dhe, në shkallë më të ulët, në restaurante dhe kafeteri. Megjithatë, në Ferizaj, romët flasin lirshëm gjuhën e tyre dhe gjuhën shqipe në kafeteri, restaurante dhe në vende të tjera publike.

Gjendja në regjionin e Mitrovicës, që vazhdon të mbetet i ndarë mes serbëve dhe shqiptarëve, mbetet çështje për shqetësim. Komuna e Mitrovicës është po ashtu gjeografikisht e ndarë përgjatë vijave etnike. Në veri të lumit Ibër, komunitetet e vogla të shqiptarëve jetojnë në numër të vogël fshatrash të Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut. Në këto tri komuna të veriut, popullata pakicë e shqiptarëve rrallë merr pjesë në jetën shoqërore të qyteteve me shumicë serbe, por në përgjithësi kufizohet në përdorimin e gjuhës vetëm në vendbanimet e tyre. Përkundër projektit të rindërtimit nga periudha e pasmarsit 2004, që është zbatuar në mënyrë të suksesshme, ritmi i kthimeve është i ngadalshëm, me vetëm dy serbë të kthyer në fshatin Frashër (Svinjare). Ata tani janë duke jetuar në pjesën jugore të Mitrovicës, ku ata nuk shkojnë në vendet kryesore urbane dhe nuk flasin gjuhën e tyre atje.

Në anën tjetër, pjesëtarët e komunitetit rom, ashkanli dhe egjiptas që janë kthyer në Mëhallën Rome, në lagjen “2 Korriku” dhe në qendrën e qytetit të Mitrovicës flasin rrjedhshëm gjuhën shqipe brenda komuniteteve të tyre dhe në raportet e tyre me popullatën shumicë si privatisht, ashtu edhe në vende publike. Ata që flasin mirë gjuhën shqipe dhe jetojnë në jug me më dëshirë flasin gjuhën shqipe në vendet publike, posaçërisht kur iu drejtohen bashkëbiseduesve shqiptarë. Pjesëtarët e komunitetit turk e flasin gjuhën e tyre në mënyrë të lirshme.

Në Mitrovicën veriore romët e zhvendosur brenda vendit përdorin gjuhën shqipe pa pengesa.

Me përjashtim të fshatit të përzier Banjaskë, serbet e Kosovës dhe komunitetet rome në komunën e Vushtrrisë jetojnë në fshatra/enklava të ndara nga popullata shumicë. Pavarësisht nga lokacioni i tregut në Stanovc të ulët, komuna e Vushtrrisë është një shembull pozitiv të praktikimit të lirisë së lëvizjes dhe përdorimit të lirë të gjuhës serbe në vendet publike. Ky është një qytet kosovar i njohur për shumëllojshmërinë dhe ofrimin e mallrave ku serbet e Kosovës nga enklavat e ndryshme furnizohen për nevojat e tyre duke përdorur lirshëm gjuhën e tyre. Perceptimi lidhur me lirinë e lëvizjes dhe përdorimin e lirë të gjuhës ndryshon varësisht nga komuniteti. Shqiptarët e Kosovës pohojnë se serbët e Kosovës e gëzojnë në nivel të kënaqshëm lirinë e lëvizjes dhe mund të përdorin gjuhën e tyre në vendet publike. Në anën tjetër, shumica e serbëve të Kosovës ndajnë mendimin se ka mungesë së lëvizjes së lirë dhe përdorim të lirë të gjuhës së tyre në vendet publike.

Në kuadër të rajonit të Prizrenit, në Rahovec bashkëveprimi mes anëtarëve të komuniteteve shumicë dhe pakicë në vendet publike ndihmohet nga fakti se të gjitha komunitetet e përdorin dialektin vendor të gjuhës “Rahovecjanqe”. Serbet e Kosovës nga pjesa e lartë e qytetit rregullit lëvizin përmes zonave të banuara me shumicë dhe përdorin gjuhën e tyre pa pengesa. Në Prizren, gjuha turke dhe dialekti/versioni vendor i kësaj gjuhe mund gjithashtu të paraqes një lloj të *lingua franca*. Këtu zakonisht fliten gjuhët shqipe, serbe, boshnjake dhe turke, dhe serbet e kthyer shpesh vërehen në qendër të qytetit, veçanërisht në supermarketet kryesore, ku ata mund të përdorin gjuhën e tyre pa pengesa. Në komunën e Dragashit, anëtarët e komunitetit goran vizitojnë rregullisht zonat e populluara me shumicë shqiptare në Kosovë dhe mund të flasin dhe përdorin gjuhën e tyre pa pengesa. Në pilot komunën e themeluar rishtazi në Mamushë komuniteti turk përfaqëson rreth 90% të popullatës së përgjithshme dhe komunitetet tjera – romët dhe shqiptarët kosovar (shumica në kontekst të PNJK) nuk ballafaqohen me probleme gjatë përdorimit të gjuhëve të tyre në vendet publike. Romët sipas raportimeve përdorin gjuhën e tyre amnore në vendet publike në Suharekë dhe Mamushë, por ata e flasin gjuhën e tyre amnore vetëm me komunitetin e tyre dhe familjarë në Prizren dhe Malishevë.

Në rajonin e Prishtinës janë vërejtur përmirësime që nga ngjarjet e muajit mars 2004. Personat që i përkasin komunitetit serb të Kosovës e përdorin gjuhën e tyre tani më lirisht se sa para vitit 2004 në vendet publike në Prishtinë (në dyqane, tregje, rrugë, bare, restorante etj.), jashtë vendbanimeve të tyre.

Në komunën e Lipjanit nuk ka pasur shenja të përmirësimit qysh nga marsi i vitit 2004 lidhur me mundësinë që komunitetet pakicë të përdorin gjuhën e tyre në vendet publike. Serbet e Kosovës dhe romët e flasin gjuhën serbe, ndihen të sigurt të përdorin gjuhën e tyre në vendet e caktuara publike, si në ndërtesën e komunës, në zonat e banuara me serbë në Lipjan dhe në fshatrat serbe të Kosovës. Ata vazhdojnë megjithatë të ndjehen të pasigurt të përdorin, dhe kufizohen nga përdorimi i gjuhëve të tyre në rrugë, dyqane, restorante dhe kafe bare që gjenden në zonat e banuara nga shqiptarët.

## **Arsimi**

**Rekomandimi i Këshillit të Evropës nr. 19 shqyrton rrugët e krijimit të mundësive për bashkëveprim mes nxënësve nga komuniteti shqiptar dhe serbë dhe përpilimin e një plani gjithëpërfshirës, i cili do të mënjanonte në mënyrë progresive barrierat, përfshirë ato gjuhësore mes nxënësve nga komunitetet e ndryshme.**

Ekziston një mungesë e vazhdueshme e bashkëveprimit mes nxënësve shqiptar dhe serbë të Kosovës e përjetësuar me prezencën e strukturave paralele të arsimit. Përpjekjet për të bashkuar shkollat paralele dhe për t'i sjellë fëmijët e të dyja komuniteteve në një klasë mësimi janë frenuar për shkak të situatës politike në Kosovë, duke minuar mundësinë e kyçjes së arsimit si një komponentë në procesin e pajtimit të komuniteteve.

Serbet e Kosovës vazhdojnë të refuzojnë shkollimin e financuar nga IPVQ-të sipas Planprogrameve të Kosovës në vend të vijimit të mësimin në strukturat paralele që ka rezultuar, sipas Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) së Kosovës, me largimin nga procesi i zhvillimit të versionit të gjuhës serbe të Planprogramit të Kosovës. Si i tillë, Planprogrami i gjuhës serbe apo tekstet shkollore në serbishte nuk janë të qasshme në sistemin e arsimit. Kjo qasje dështon obligimin e IPVQ-së për të ofruar dhe siguruar qasje në arsim në të dyja gjuhët zyrtare dhe për të siguruar përdorim të barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe dhe alfabetëve përkatëse në fushën e arsimit. Megjithatë, është një lloj e rëndësishme që të theksohet se zhvillimi i versionit të gjuhës serbe duhet të bëhet vetëm në bashkëpunim dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve serbe të Kosovës. Duke qenë larg nga promovimi i dyanshëm i mirëkuptimit dhe integritit, scenariot e vazhdueshme përjetësojnë ndarjen gjuhësore mes komuniteteve folëse shqiptare dhe serbe.

Rëndësia e Planprogramit të gjuhës serbe nuk duhet megjithatë të mbivlerësohet për sa i përket mënjanimit të barrierave për përmirësimin e bashkëveprimit mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Presioni brenda komunitetit serbë të Kosovës mbi prindërit për të dërguar fëmijët e tyre në këto shkolla dhe mbështetja e arsimtarëve serbë të Kosovës nga buxheti i Republikës së Sërbisë, të cilit marrin paga shumë më të larta se kolegët e tyre që punojnë në sistemin arsimor të IPVQ-ve, kontribuon në ndarjen e popullatës dhe përjetëson strukturat paralele të arsimit. Këta dy skenarë nuk duhet të thirren për të justifikuar largimin e IPVQ-së nga aprovimi i versionit në gjuhën serbe. Ato ende paraqesin gjendjen dhe sfidat e së ardhmes, të cilat duhet të kapërcehen për të avancuar procesin e pajtimit dhe bashkimit të nxënësve shqiptar dhe serbë të Kosovës në të njëjtën klasë mësimi. Faktori tjetër që pengon përpjekjet për t'i bashkuar nxënësit shqiptar dhe



serbë të Kosovës është ndryshimi i dukshëm mes dy gjuhëve. Prandaj, integrimi do të kërkojë që këta nxënës të kenë aftësi të mjaftueshme gjuhësore nga të dyja gjuhët. Hapi i parë drejt zvogëlimit të kërkesës për shkollat paralele për arsimtarët serbë të Kosovës, prindërit dhe nxënësit, është që të vërtetohet se sistemi i arsimit, i financuar nga IPVQ-të, dhe Planprogrami i Kosovës përputhen me shërbimet e ofruara nga shkollimi paralel. Hapi i dytë kërkon nga MASHT-i të zhvilloj një model të shkollimit dy gjuhësor, në gjuhët shqipe dhe serbe, për të akomoduar nevojat individuale të secilit komunitet, duke pasur gjithashtu për qëllim krijimin e një fushe të komunikimit dygjuhësor. Pa këto zhvillime plotësuese progresi i integritit të serbëve të Kosovës në Planprogramin e Kosovës do të vazhdojë të ngec në baltë.

### **Rekomandimi nr. 20 i Këshillit të Evropës rregullon brengat e personave nga radhët e komuniteteve pakicë dhe fut masa që mund të zvogëlojnë kërkesat për mbajtjen e sistem paralel të arsimit.**

#### *Arsimi fillor dhe i mesëm*

Planprogrami i gjerë i Kosovës mësohet në tri gjuhë, në shqip (gjuhë zyrtare), atë boshnjake dhe turke. Siç është përshkruar më lartë, për shkak të ngurrimit të serbëve të Kosovës për t'u kyçur në dialog me IPVQ-të, në veçanti me MASHT-in, nuk është krijuar versioni i Planprogramit të Kosovës në gjuhën serbe.

Në pajtim me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/19 mbi Ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë (Ligji mbi arsimin), MASHT-i ka siguruar krijimin e planprogrameve në gjuhët boshnjake dhe turke për të gjitha nivelet e shkollimit fillor dhe të mesëm. Duke iu referuar arsimit të detyrueshëm (niveli 1 deri 9), publikimi i teksteve shkollore sipas Planprogramit të IPVQ-së është duke përparuar ndonëse me disa vështirësi. Tekstet shkollore ekzistojnë për klasat 1-rë, 2-të, 6-të, 7-të dhe 9-të. Për klasat e 3-ta, 4-ta dhe 8-ta kompletimi i teksteve është në proces e sipër kurse për klasën e 5-të nuk ka tekste. Duhet gjithashtu të ceket se problemet e përjetuara nga komunitetet pakicë janë ndarë me komunitetin shumicë shqiptar të Kosovës. Mungesa e teksteve shkollore dhe kualiteti i këtyre teksteve të nivelit fillor është brengë e përgjithshme në Kosovë dhe ky problem nuk duhet kuptuar si një “problem specifik i minoriteteve”.

Sa i përket arsimit të mesëm gjendja është më shumë urgjente për shkak se nuk ka tekste shkollore sipas planprogramit në gjuhët ekzistuese të pakicave. Sipas IPVQ-së, shkaku kryesor për këtë qëndron në numrin e lartë të mësimeve karshi numrit të vogël të nxënësve të arsimit të mesëm të komuniteteve pakicë. Kjo e bënë shtypjen e teksteve ekonomikisht jo tërheqëse për shtëpitë botuese të teksteve shkollore. Në vend të kësaj, tekstet merren zakonisht nga Bosnja dhe Hercegovina (për gjuhën boshnjake) dhe nga Turqia (për gjuhën turke) dhe ato i referohen programeve mësimore dhe identitetit historik dhe kulturor të atyre shteteve.

Arsimi në gjuhën boshnjake dhe turke zhvillohet përmes pesë lëndëve kombëtare (histori, gjuhë, letërsi, art dhe muzikë) dhe përmes lëndëve të përgjithshme të përkthyer nga tekstet shkollore të gjuhës shqipe. Ekzistojnë disa probleme lidhur me kualitetin e përkthimeve të teksteve të tilla shkollore të lëndëve të përgjithshme. Në përgjithësi,

lëndët kombëtare kujdesën që të reflektojnë historinë dhe kulturën e atyre shteteve farefisnore (BiH dhe Turqisë) se sa të reflektojnë historinë dhe kulturën e komuniteteve boshnjak dhe turk folëse në Kosovë. Kjo është veçanërisht e vërtet për tekstet e importuara shkollore.

Mundësit për arsim dygjuhësor ekzistojnë sipas ligjit të zbatueshëm. Fëmijët që mësojnë në gjuhët e minoritarëve mund të kenë qasje në dy orë mësimi në javë në baza vullnetare të mësimi në gjuhën shqipe, nëse prindërit e fëmijëve e dëshirojnë një gjë të tillë. Duhet të përpilohet një planprogram formal për një mësim të tillë dygjuhësor.

#### *Arsimi terciar*

Në përgjithësi ekziston numër i kufizuar i programeve studimore në gjuhën boshnjake dhe turke në kuadër të universiteteve publike në Kosovë. Mundësitë për arsim në gjuhë amtare zvogëlohen në mënyrë progresive për këto komunitete gjatë kalimit nga arsimi fillor në atë terciar, gjersa rritet mësimi në gjuhën shqipe.

Ekzistojnë dy programe mësimi në gjuhën boshnjake: një në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara për afarizëm në Pejë (70 vende për një vit akademik) dhe tjetri në Fakultetin e Mësuesisë në Prizren (30 vende për një vit akademik). Sa i përket arsimi të lartë në gjuhën turke, është ofruar një program mësimor në Fakultetin e mësuesisë në Prizren dhe është ofruar një mësim i filologjisë së gjuhës turke në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë (së bashku me studimet *Master* në gjuhën dhe letërsinë turke). Nga 123 programe *Bachelor*, katër programe janë ofruar në gjuhët minoritare (3.2%). Universitetet e udhëhequra nga IPVQ-të nuk kanë zhvilluar planprograme fakultetesh dhe programe në gjuhën zyrtare serbe. Në pajtim me ligjin e zbatueshëm, i cili rregullon përdorimin e gjuhëve, universitetet publike i është garantuar statusi autonom. Kjo nuk siguron medoemos përpilimin e planprogramit në gjuhën serbe apo programe mësimi si kërkesë mandatare. Siç është thënë në Ligjin mbi gjuhët, “përdorimi i gjuhëve zyrtare dhe i ndonjë gjuhe tjetër në programet arsimore përcaktohet nga universitetet përmes rregulloreve të tyre” (neni 23.2).

Universiteti në Mitrovicë (UiM), i cili udhëhiqet nga Ministria e arsimit e Republikës së Serbisë, siguron arsimim të lartë në gjuhën serbe. UiM ka kryer procesin e reformës gjithëpërfshirës qysh në vitin 2001 me qëllim të arritjes së objektivit të standardeve evropiane dhe anëtarësimit në Asociacionin e universitetit evropian. Progresi i arritur nga UiM është pranuar në mënyrë eksplicite në mars të vitit 2007, kur PSSP-ja e nënshkroi Vendimin ekzekutiv të UNMIK-ut 2007/17 mbi vazhdimin e akreditimit të UM-së, duke urdhëruar UM-në që të aprovojë strukturat udhëheqëse demokratike, si për shembull zgjedhjen e rektorit të ri të UM-së dhe aprovimin a Statutit të ri të Bolonjës, të datës dhjetor 2006, i cili zbaton linjat e veprimit të Bolonjës. Megjithatë, UiM-i refuzon to bashkëpunoj me IPVQ-në për shkak se UiM-ja nuk financohet nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës.

UiM ka për momentin 10 fakultete me 8,474 studentë të përfshirë në vitin akademik 2004/2005 (të dhënat e fundit ekzistuese). Ka një staf të përgjithshëm prej 1,329, prej të cilëve 539 janë profesorë, 406 janë asistentë dhe 384 janë personel teknik. UiM

gjithashtu ofron kurse studimore në lokacionet tjera në Kosovë, për shembull në fshatin Ranillug në Kamenicë, kurse të Fakultetit të gjuhëve.

Për vitin akademik 2007/2008 personave nga radhët e minoriteteve pakicë i është ofruar mundësia të regjistrohen në çdo program studimi në Universitetin e Prishtinës përmes një sistemi të vendeve të rezervuara; numri i përgjithshëm i rezervuar është 107 të ndarë mes 17 fakulteteve dhe mes komuniteteve boshnjak (44), turk (25) dhe romë, ashkanli dhe egjiptian (38). Kjo nënkupton se 1.4% nga numri i përgjithshëm ekzistues (7,669) i vendeve të caktuara janë rezervuar për anëtarët e komuniteteve pakicë. Siç është paraparë me rregulloret e UP-së mbi politikën e pranimit, kandidatët jo kosovar dhe ata minoritar kanë të drejtë të konkurrojnë dhe të pranohen vetën për numrin e rezervuar për ta (faqe 1). Personat nga radhët e komuniteteve pakicë konkurrojnë në baza të barabarta në kuadër të komunitetit për numrin e caktuara të vendeve.

### **Rekomandimi nr. 21 i Këshillit të Evropës shqyrton si çështje urgjente çështjen e transportit të sigurt të nxënësve nga komunitetet minoritare deri te godinat shkollore.**

Sipas nenit 22.1 të Ligjit mbi arsimin në Kosovë është obligim i komunave që të aranzhojnë transport të sigurt dhe efikas për nxënësit e mësimin të obligueshëm deri në shkollat e tyre. IPVQ mbështet transportimin e nxënësve nga radhët e komuniteteve pakicë deri te godinat shkollore, përfshirë edhe transportin deri te strukturat paralele me financim komunal dhe qendror. Autoritetet komunale e kanë për detyrë që të sigurojnë qasje fizike në shkolla për të gjithë nxënësit. Megjithatë, për shkak të faktit se qasja fizike në godina shkollore me mësim në gjuhën amnore është një çështje problematike veçanërisht për komunitetet pakicë, janë miratuar masa specifike të niveleve të ndryshme për të përmbushur këtë nevojë të veçanta. Kjo aplikohet në mënyrë specifike por jo ekskluzivisht ndaj komunitetit serb të Kosovës, liria e lëvizjes se të cilëve është ende e kufizuar.

Arsimi fillestar është i mundshëm në kuadër të rajoneve të populluara me pakica. Aty ku numri i nxënësve nuk është i mjaftueshëm për të krijuar

një klasë, atëherë ato komuna<sup>30</sup> anëmbanë Kosovës duhet të sigurojnë shërbimet e transportit deri te fshati më i afërt. Kjo gjithashtu aplikohet për shkollim të mesëm.

---

<sup>30</sup> Ky është rasti me: Shtërpçë, Kamenicë, Gjilan (në veçanti prej kthimit të romëve nga vendi Abdullah Presheva në shkollën fillore në fshatin Shillovë), Novobërdë ( e kufizuar për vitin shkollor 2006/2007 për nxënësit serb të Kosovës nga fshati Bostan dhe Tërmiqec); Viti, Klinë (ku Zyra komunale për komunitete ofron transport për dy fëmijë serb kosovar që jetojnë në fshatin Dresnik deri në shkollën paralele në fshatin Videjë; Pejë (për studentët serb të Kosovës nga fshati Bellopojë në shkollën fillore dhe të mesme në Gorazhdec); Rahovec (për nxënësit serb të Kosovës nga fshati Hoqa e Madhe në shkollën e mesme në Rahovec); Dragash (për një numër të kufizuar të nxënësve goran/boshnjak të shkollave të mesme); Prizren (për boshnjakët të Kosovës, nxënësit e shkollës së mesme nga fshati Lubinjë e Poshtme në qytetin e Prizrenit); Prishtinë (për nxënësit serb të Kosovës nga fshatrat Llapllasellë, Preoc dhe Cagllavicë dhe pjesën rurale të Gracanicës); Lipjan (për nxënësit serb dhe rom të Kosovës nga Janjeva në shkollën e mesme në Gracanicë, Lapna Sellë dhe qytetin e Lipjanit); Obiliq (ku tre minibusë menaxhohen nga komuna ndonëse në pamundësi për t'u përdorur për shkak të regjistrimit); Fushë Kosovë (për nxënësit serb të Kosovës në dy shkolla fillore paralele, në Bresje dhe Uglar); Leposaviq (për nxënësit shqiptar nga fshatrat

Shërbimi i transportit sigurohet me minibusë, shpesh të dërguar si donacion nga agjencitë ndërkombëtare, dhe që udhëhiqen ose drejtpërdrejt nga zyrat komunale për komunitete apo në mënyrë indirekte nga kontraktuesit privat.

Sa i përket arsimit të lartë, studentët nga komunitetet pakicë transportohen sipas projektit me autobusë humanitarë, që tani janë nën përgjegjësinë e IPVQ-ve dhe MTT-së. Shërbimi i transportit me autobus humanitar menaxhohet nga kompania vendore transportuese “Kolasin Prevoz”. Përfituesit e këtij projekti janë ekskluzivisht serbet e Kosovës që jetojnë në jug të lumit Ibër, dhe në mesin e tyre edhe studentët që studiojnë në Universitetin e Mitrovicës veriore. Përveç kësaj, në rajonin e Gjilanit studentët serbë të Kosovës gjithashtu përfitojnë nga shërbimet transportuese, që financohet nga Qendra Bashkërenduese për Kosovë dhe Metohi.

**Rekomandimi nr. 22 i Këshillit të Evropës shqyrton nevojat ekzistuese për shkollim në gjuhët e komuniteteve pakicë, përfshirë qartësimin e pragut për hapjen e një klase me mësim në gjuhë të pakicave me qëllim të rregullimit të kërkesave të shtruara nga komunitetet numerikisht ma të vogla dhe me qëllim të ndërmarrjes së masave për të ofruar tekste shkollore dhe arsimtarë të kualifikuar për mësim në gjuhën amtare.**

Në tetor të vitit 2007, MASHT-i ka bashkëdrejtuar një seri të tryezave të rrumbullakëta së bashku me OSBE-në, UNMIK-un, UNICEF-in dhe Këshillin e Evropës lidhur me arsimin për komunitetet pakicë në Kosovë. Qëllimi i këtyre tryezave të rrumbullakëta ishte që të shqyrtohen nevojat e arsimit të komunitetit boshnjak, goran dhe turk të Kosovës. OSBE-ja në pranverë të vitit 2007 ka vlerësuar se tryezat e rrumbullakëta kanë rrjedh si nevoja e secilit komunitet pakicë. Tryezat e rrumbullakëta për serbet e Kosovës dhe komunitetet kroate pritet të mbahen në fund të vitit 2007 apo në fillim të vitit 2008. Nevojat e arsimit të komunitetit romë, ashkanli dhe egjiptian janë shqyrtuar në Strategjinë e Qeverisë për integrimin e komuniteteve romë, ashkanli dhe egjiptian dhe prandaj nuk formojnë pjesën e serive të tryezave të rrumbullakëta.

Shih gjithashtu komentet nën rekomandimin nr. 20.

**Rekomandimi nr. 23 i Këshillit të Evropës siguron ndërmarrjen e hapave vendimtar për t'i shqyrtuar nevojat për arsimin të komuniteteve rom, ashkanli dhe egjiptian, përfshirë edhe sigurimin e qëndrueshmërisë së programeve të hartuara për t'i ndihmuar nxënësit e këtyre komuniteteve për tu integruar dhe mbetur në sistemin e arsimit.**

Nga viti 2004 deri më 2007 MASHT-i ka zbatuar, në bashkëpunim me OSBE-në, projektin e mësimave plotësuese për romët ashkanlitë dhe egjiptianët për të mundësuar integrimin e fëmijëve të cenueshëm romë, ashkanli dhe egjiptianë në sistemin e arsimit të Kosovës. Projekti ka caktuar nëntë komuna të Kosovës (Prishtinën, Lipjanin, Suharekën, Pejë, Istogun, Shtimen, Gjakovën dhe Fushë Kosovën) me numrin më të madh të

---

Koshutovë dhe Cerajë në Bistricë); Mitrovicë (për nxënësit e kthyer romë nga Mahalla Rome, Mitrovicë jugore në shkollë në Mitrovicën veriore).

fëmijëve të komuniteteve rom, ashkanli dhe egjiptian që nuk janë regjistruar në shkolla të rregullta.

Planprogrami i mësimet plotësues ka aplikuar një metodologji speciale për t'ia mundësuar nxënësve të kryejnë dy klasë brenda një viti shkollor. Përveç kësaj, janë planifikuar aktivitetet shtesë të planprogramit për t'u kujdesur për angazhimin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian së bashku me shokët e tyre në shkollat me rrjedhë të rregullt për të mundësuar integrimin e tyre të plotë në sistemin shkollor. Mësimet plotësuese i kanë vijuar gjithsej 1,751 nxënës të komuniteteve rom, ashkanli dhe egjiptian, dhe nga ky numër, në tri vitet e fundit janë regjistruar 565 fëmijë në shkolla fillore të rregullta. MASHT-i dhe Departamentet komunale të arsimit e kanë financuar projektin me 249,817 €uro për pagesën e të ardhurave të arsimtarëve nga viti 2004 deri më 2007.

Në vitin 2006 IPVQ-të janë zotuar të zhvillojnë një strategji për integrimin e romëve, ashkanlive dhe egjiptianëve në bashkëpunim me OSBE-në dhe Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur. Pritet që kjo strategji të kryhet deri në fund të vitit 2007, gjersa procesi i zbatimit sipas kornizës së zbatimit të strategjisë së të drejtave të njeriut do të fillon atëherë kur të aprovohet strategjia e integrimit për romët, ashkanlitë dhe egjiptianët nga IPVQ-të. Strategjia e fundit mbyll të gjitha çështjet përkatëse kyçe për të avancuar një integrim të qëndrueshëm të këtyre komuniteteve në shoqërinë e gjerë kosovare, përfshirë edhe komponentët thelbësore të arsimit.

Në marrëveshje me rekomandimet e zhvillimit për strategjinë e integrimit të romëve, ashkanlive dhe egjiptianëve, MASHT-i ka zhvilluar strategjinë e vetë për të përmirësuar arsimin e fëmijëve romë, ashkanli dhe egjiptian me titull "Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkanli dhe egjiptian në Kosovë - komponent e arsimit 2007-2017" që është aprovuar zyrtarisht nga MASHT-i në shtator të vitit 2007. Periudha zbatuese e kësaj strategjie të ndarë do të vendoset pas zgjedhjeve dhe formimit të qeverisë së re të IPVQ-ve. Duhet megjithatë të theksohet se anëtarët e komuniteteve romë, ashkanli dhe egjiptian në përgjithësi flasin shqip dhe serbisht, dhe për tu integruar në kuadër të komunitetit shumicë ata mund t'i ndjekin mësimet në shkolla në gjuhën shqipe apo serbishte.

**Rekomandimi nr. 24 i Këshillit të Evropës lejon fleksibilitet në zbatimin e reformës së arsimit në raport me nxënësit e komunitetit goran, të cilit ende nuk janë integruar në sistemin e ri të arsimit.**

Qysh nga ë viti shkollor 2002/2003, një planprogram i gjerë i Kosovës i adaptuar sipas standardeve evropiane të arsimit është në përdorim në shumicën e shkollave të financuara nga IPVQ-të. Gjatë kësaj periudhe, MASHT-i ka pranuar largimin vjetor për komunitetin goran për vitet shkollore deri në vitin shkollor 2006-2007 në mënyrë që të vazhdojnë shkollimin e tyre sipas sistemit shkollor të mëhershëm në gjuhën serbe. Për ata nxënës goranë, të cilit mbarojnë shkollimin fillor dhe nivelin e parë të mesëm në strukturat arsimore paralele të shkollave të mesme (tetë klasë) dhe që kanë dëshirë të vazhdojnë mësimin në nivel më të lartë të shkollimit të mesëm kanë mundësi të regjistrohen në

klasën e parë të nivelit e lartë të shkollimit të mesëm sipas planprogramit të Kosovës. Paralelisht me mësimet e klasës së parë sigurohet edhe mësimi plotësues për nxënësit goranë, të cilit nuk e kanë mbaruar shkollën e obliguar 9-të vjeçare të zbatuar në vitin shkollor 2002/2003. Në nivelin e lartë të shkollimit të mesëm prindërit e nxënësve goranë mund të zgjedhin gjuhën e mësimin, atë shqipe ose serbe.

Për vitin shkollor 2007/2008 MASHT-i ka vendosur të vazhdojë me sistemin e lirimit. Siç u pa, shkollat paralele janë përfillur qysh nga reforma shkollore por IPVQ-të gjithashtu pranojnë se këto lehtësira shkollore nuk duhet të jenë një sistem për furnizimin e nevojave të shkollimit për komunitetin goran. Këto duhet të shqyrtohen dhe rregullohen në kuadër të sistemit arsimor të Kosovës. Duke qenë larg nga avansimi i integritit dhe shoqërimit në shoqërinë kosovare, ndjekja e mësimin në strukturat paralele përjetëson distancën e nxënësve goranë nga popullata e gjerë. Duke pasur në fuqi Ligjin mbi shkollimin fillor dhe të mesëm, Planprogrami i ri i Kosovës ka mjete për të ofruar shërbime bashkërenduese që për momentin ofrohen nga strukturat paralele. Në fund të muajit tetor të vitit 2007, MASHT-i u takua me komunitetin goran për të diskutuar mundësit e rregullimit të nevojave të atij komuniteti. Rezultati i tryezës së rrumbullakët duhet ende të shihet, megjithatë, ky takim ka ofruar një mundësi për MASHT-in, për autoritetet komunale dhe përfaqësuesit e komunitetit goran që t'i përmbushin dhe ta shqyrtojnë gjendjen e tanishme dhe së bashku të diskutojnë masat që ujdysin interesat e të gjitha palëve me interes.

## **Pjesëmarrja**

### **Rekomandimi nr. 25 i Këshillit të Evropës siguron pjesëmarrjen kuptimplote dhe kontributet e personave të të gjitha komuniteteve në bisedimet lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës**

Fuqitë e larta politike jashtë Kosovës kanë urdhëruar që bisedat të përfshijnë politikanët e lartë shqiptar dhe serbë. Lidhur me këtë, interesat e minoriteteve rregullohen përmes organit këshillimor të Këshillit konsultativ të Komunitetit të themeluar nga Zyra e kryetarit të Kosovës. Për ma tepër, procesi i statusit gjithashtu përfshinë elemente tjera, si procesion e konstituimit dhe përgatitjen e një baze të fortë ligjore. Në këtë mënyrë, komunitetet pakicë kyçen në procesin e statusit duke marrë pjesë në dialog për gjendjen e legjislacionit, në veçanti përmes Komisionit për të drejta të komuniteteve dhe interesave dhe kthime për tu siguruar se kontributi i tyre po merret në konsideratë në procesin e konstituimit dhe legjislativitet para se të zgjidhet statusi.

### **Rekomandimi nr. 26 i Këshillit të Evropës ushtron përpjekje për të siguruar pjesëmarrjen e përmirësuar të personave nga radhët e komuniteteve pakicë në strukturat dhe proceset e IPVQ-ve.**

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36, procesi i rekrutimit tek Shërbimi civil i Kosovës urdhërohet nga një sistem i kuotave etnike për të siguruar përfaqësim të drejtë të

komuniteteve pakicë tek autoritetet qendrore dhe publike, përfshirë edhe SHPK-në. Prandaj, komuniteteve pakicë ju sigurohet qasje në autoritetet vendimmarrëse në nivel lokal dhe qendror. Shënimet statistikore për vitin 2007 të numrit të personave që i takojnë komuniteteve pakicë e që punojnë në shërbime civile nuk janë siguruar.

Ekziston një ngrirje e tanishme e punësimit dhe zvogëlimit të vendeve të punës në Shërbimin civil të Kosovës. IPVQ janë zotuar të sigurojnë se ky proces nuk ka asnjë efekt të kundërt në përfaqësimin e komuniteteve pakicë. Shuma e zvogëluar e buxhetit maksimal për autoritetet komunale dhe qendrore ka krijuar tepriç të vendeve të punës dhe ristrukturim të administratës publike për të pasur efikasitet dhe ekonomizim. Shumica e ministrive të IPVQ-ve janë pajtuar që pas heqjes së ngrirjes në punësim secila njësi për resurse njerëzore përkatëse do të sigurojë se kuota e caktuar me ligj do të përmbushet.

**Rekomandimi nr. 27 i Këshillit të Evropës siguron dialogë të rregullt kuptimplote mes ministrive përkatëse qeveritare dhe Komisionit për të drejta dhe interesa të komuniteteve të Kuvendit të Kosovës.**

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve (KDIK) është një prej komisioneve kryesore të Kuvendit të Kosovës. I themeluar në vitin 2001 pas zgjedhjeve të para preliminare, KDIK-u përbëhet prej 13 anëtarëve. Secili komunitet e ka nga një përfaqësues në këtë komision.

Plani punues i vitit 2007 i KDIK-ut parasheh mbajtjen e kontakteve të rregullta me komisionet komunale për kthime dhe me MAPL-in dhe ministrinë tjera përkatëse. Kjo gjithashtu përfshinë sektorin mbi bashkëpunim me MALP-in, që i është përshtatur propozimit gjithëpërfshirës të Ahtisarit dhe agjendës së tij legislative. Dialogu dhe bashkëpunimi mes KDIK-ut, Komisionit komunal për kthime, MALP-it dhe të gjitha ministrive tjera mund ende të përmirësohet edhe më shumë, në veçanti mes KDIK-ut dhe Komisionit komunal për kthime. Staf i civil nga ministrinë e ndryshme që merë pjesë në takimet e KDIK-ut janë ata nga ministria sponsoruese e një projektligji që gjendet në agjendën e përditshme të KDIK-ut. Prandaj, ata ftohen të marrin pjesë në takimet e KDIK-ut sipas nevojës, që do të thotë kur anëtarët e komisionit të kenë pyetje për një projektligj specifik.

**Rekomandimi nr. 28 i Këshillit të Evropës shqyrton mënyrat për të përmirësuar përfaqësimin dhe efikasitetin e komisioneve për komunitete në komuna.**

Komisioni i komuniteteve (KK) është një mekanizëm i detyrueshëm të cilin duhet emëruar secila komunë sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30. Së bashku me Zyrën komunale për komunitete, KK-ë funksionon si një mekanizëm i komunitetit për mbrojtje kundër diskriminimit për të siguruar që secili komunitet lokal, pa marr parasysh madhësinë e tij, gjuhën, fenë, origjinën etnike apo ndonjë karakteristikë tjetër të anëtarëve të tij, do të ketë tretman të njëjtë nga autoritetet komunale.

Që nga marsi i vitit 2004 është emëruar nga një KK-ë në 27 prej 30 komunave<sup>31</sup> në Kosovë. Për shkak të paqartësisë politike në Kosovë dhe për shkak të ritmit të ngadalshëm të integritit të komuniteteve, një numër i KK-ve nuk i kanë pasur të zgjedhur të gjithë anëtarët apo nuk janë takuar me rregull. Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të KK-së është dëshmuar si detyrë e vështirë, veçanërisht në kapërcimin e rezistencës nga përfaqësuesit e komuniteteve pakicë sa i përket pjesëmarrjes. Disa KK-ë takohen vetëm një herë në muaj gjë që e minon punën e tyre dhe besimin e komunitetit.

**Rekomandimi nr. 29 i Këshillit të Evropës intensifikon përpjekjet për të siguruar që personat që i përkasin të gjitha komuniteteve mund në mënyrë efektive të marrin pjesë në jetën shoqërore dhe ekonomike në Kosovë, duke vëzhguar se si procesi i privatizimit dhe rezultatet e tija ndikojnë dhe përfshijnë komunitetet pakicë.**

Në vitin 2005 Enti statistikor i Kosovës ka kryer një studim të fuqisë punëtore, duke ofruar të dhëna të besueshme mbi treguesit e tregut të punës. Sipas studimit të vitit 2005, numri i të papunëve kishte arritur në 41.4%. Niveli i papunësisë është një çështje problematike për të gjitha komunitetet, ndonëse përqindja e papunësisë është më e lartë tek komunitetet e vogla dhe më të cënueshmet, si te goranët, romët, ashkanlitë dhe egjiptianët. Sipas studimit të pagave dhe aftësive të organizatave ndërkombëtare të punës (mars 2006) të përbërë prej 12,126 punëtorëve të punësuar në 1,547 ndërmarrje, kryesisht në kompanitë private, vetëm 0.1% të personave që punojnë në këto ndërmarrje janë romë, ashkanli dhe egjiptian, që do të thotë rreth 12 vetave. Në shërbimin civil publik komunitetet jo shqiptare përbëjnë gjithsej 10% të numrit të përgjithshëm, domethënë rreth 7000 persona.

Donatorët ndërkombëtarë dhe institucionet vendore kanë bërë disa përpjekje për të përmirësuar përqindjen e ulët e punësimit<sup>32</sup>. Për shembull, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është duke përgatitur një bashkëpunim të mundshëm me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) mbi zhvillimin e një strategjie për autorizimin e personave të komuniteteve pakicë në biznesin privat përmes stimulimit, si përmes subvencioneve. Programet tjera sponsoruese përbëhen nga shtimi i mundësive të punësimit përmes trajnimeve për vende pune dhe përmes trajnimeve para punësimit, duke mbështetur punët që gjenerojnë të ardhura, duke i ofruar ndihmë dhe grante fermerëve, dhe përmes mbështetjes profesionale si kontabilitetit dhe auditivit në Kosovë, duke themeluar një shoqëri për kontabilist të certifikuar dhe auditor. Ky investim do të shpie në një sektor të qëndrueshëm privat në Kosovë, duke krijuar vende pune dhe të ardhura për familjet e të gjitha komuniteteve.

Në Kosovë, procesi i privatizimit që kontrollohet nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit është në mbarim e sipër me pjesën e madhe të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore dhe publike të privatizuara ose me proces të gatshëm për privatizim. Sipas procesit të privatizimit punëtorët e ndërmarrjeve të privatizuara kanë të drejtë në 20% të shumës së përgjithshme të vlerës së kompanisë.

<sup>31</sup> Ende nuk janë emëruar në Glllogovc, Kaçanik dhe Malishevë.

<sup>32</sup> Shih komentet më lartë: Çështjet e kthimit dhe problemet e sigurisë, punësimi.



## **Mbrojtja kundër ndërrimit e popullatës**

**Rekomandimi nr. 30 i Këshillit të Evropës siguron respektimin e së drejtës për kthim dhe që procesi i kthimit që garanton zgjedhjen e vendit për kthim në Kosovë të organizohet në atë mënyrë që të përjashtoj manipulimet politike.**

Shih komentet nën rekomandimet 10 – 11.

**Rekomandimi nr. 31 i Këshillit të Evropës siguron që çdo plan i propozuar i decentralizimit të lejoj konsultimet thelbësore të anëtarëve të komuniteteve pakicë dhe të respektoj plotësisht parimet e nenit 16 të kornizës së konventës.**

Nuk ka përparime për të raportuar

## **Kontaktet ndërkufitare**

**Rekomandimi nr. 32 i Këshillit të Evropës ushtron përpjekjet për shqyrtimin e pengesave të mbetura rreth kontaktet ndërkufitare në rajon.**

Nuk ka përparime për të raportuar.

**Shtojca I****Tabela 1: Disponueshmëria me njësi të përkthimit në ministritë e IPVQ-ve**

Njësit e përkthimit në institutet e administrimit qendror

Nr.	Institucioni	Numri i përgjithshëm i përkthyesve dhe lektorëve	Numri i përkthyesve shqip – serbisht - shqip	Numri i përkthyesve shqip-anglisht-shqip	Numri i lektorëve
1.	ZKM	5	3	2	0
2.	MSHP	10	3	5	2
3.	MAPL	5	2	3	0
4.	MFE	4	1	2	1
5.	MKRS	3	2	1	0
6.	MPMS	3	2	1	0
7.	MTI	4	2	1	1
8.	MSH	2	1	1	0
9.	MASHT	4	2	2	0
10.	MEM	2	1	1	0
11.	MMPH	8	1	6	1
12.	MKK	3	2	1	0
13.	MTTK	2	1	1	0
14.	MBPZHR	4	2	2	0
15.	MD	11	3	8	0
16.	MPB	3	2	1	0
Gjithsej:		73	30	38	5

Burimi: MSHP, Njësia Qendrore Vëzhguese Gjuhësore, gusht 2007

## Shtojca II

**Tabela 2: Vlerësimi i kapaciteteve të përkthimeve/interpretimeve të komunave në Kosovë që nga prilli i vitit 2007**

Pajisjet e njësive të përkthimit/interpretimit/trajnimet/burimet financiare

Nr.	Komuna	Nishtë e themeluar të përkthimit	Numri i ndihmësve gjuhësorë				Stafi i rrafshues hëm Y/N	Trajnimet (3)	Përkthimi simultan	Interpretimet nga mbledhjet (4) kur kërkohet/N	Mjetet e lejuara financiare adekuate ? Y/N	LFP(5) të punësuar/N
			Shqip - serbisht	Shqip(serbisht)-anglisht	Gjuhë tjera (1)	Gjithsëj (2)						
1.	Deçan	N	1	0	0	1	N	?	Y	R	N	Y
2.	Gjakovë	Y	2	0	0	2	N	Y	P	Y	N	Y
3.	Gllgovc	N	0	0	0	0	N	N	Y	N	N	N
4.	Dragash	Y	4	0	0	4	Y	Y	Y	Y	Y	Y
5.	Istog	Y	2	0	1	2	Y	Y	Y	Y	N	Y
6.	Kaçanik	N	0	0	0	0	N	N	P	N	N	Y
7.	Gjilan*	Y	2	1	0	3	Y	?	Y	Y	Y	Y
8.	Klinë	Y	1	0	0	1	N	?	Y	Y	Y	Y
9.	Fushë Kosovë	Y	1	1	0	2	N	?	Y	Y	N	Y
10.	Kamenicë	Y	2	0	0	2	Y	?	P	R	Y	Y
11.	Mitrovicë	Y	2	0	0	2	N	Y	P	R	N	Y
12.	Lëpoviq	Y	1	0	0	1	N	N	P	R*	N	Y
13.	Lipjan	Y	3	0	0	3	Y	?	Y	Y	Y	N
14.	Novobrdë	Y	10	0	0	10	N	N	P	Y	Y	Y
15.	Obiliq	Y	2	0	0	2	Y	?	Y	Y	Y	Y
16.	Rahovec	Y	1	0	0	1	N	N	Y	R	N	N
17.	Pejë	Y	1	1	0	2	N	Y	Y	R	N	Y
18.	Podujevë	Y	2	0	0	2	Y	Y	Y	R	Y	Y
19.	Prishtinë**	Y	4	0	0	4	Y	?	Y	Y	Y	Y
20.	Prizren***	Y	3	0	1	4	Y	Y	Y	Y	N	Y
21.	Sкендерaj	N	1	0	0	1	N	N	N	N	N	N
22.	Shtime	Y	1	0	0	1	N	N	Y	R	N	Y
23.	Shtërpcë	Y	2	0	0	2	N	Y	Y	Y	N	Y
24.	Suharekë	Y	2	0	0	2	N	?	Y	R	N	Y

25	Ferizaj	Y	4	0	0	4	Y	N	Y	Y	Y	Y
26	Viti	Y	2	0	0	2	N	?	Y	Y	N	N
27	Vushtrri	Y	1	0	0	1	N	?	Y	R	Y	Y
28	Zubin Potok	N	0	0	0	0	N	N	N	R*	N	N
29	Zveçan	N	0	0	0	0	N	N	N	R*	N	N
30	Malishevë	N	0	0	0	0	N	N	P	N	N	Y
31	Mamushë (NKP)**	Y	0	0	1	1	Y	N	N	Y	Y	N
32	Hani Elezit	N	0	0	0	0	N	N	N	N	N	N
33	Junik (NKP)	N	0	0	0	0	N	N	N	N	N	N
	33	(Y)	48	3	3	53	(y)	(y)	(y)	(y)	(y)	(y)
Gjithsej :		24					11	8	20	15	11	24
gjithsej :	3	(N)	/	/	/	/	(N)	(N)	(P)	(R)	(N)	(N)
Gjithësej	6	Total	/	/	/	/	(Total)	?	(N)	(N)	(Total)	(T)
ës		33					11	11	6	6	33	33
ej								6				

Legjenda: PNK do të thotë Pilot njësia komunale. Shq=shqip, ser.=serbisht ang=anglisht. \*Komunat që njohin gjuhë tjera zyrtare apo që kanë gjuhë në përdorim zyrtar. \*\* Komunat që përdorin gjuhë tjera të komuniteteve ndonëse zyrtarisht nuk pranohet. (1) Gjuhë tjera komunale do të thotë gjuhët zyrtare komunale, gjuhët që përdoren zyrtarisht apo gjuhë e komunitetit e papranuar zyrtarisht por në praktikë përdoren nga komunat. (2) Një asistent gjuhësor mund të përdoret për më shumë se një gjuhë dhe numri total i asistentëve gjuhësor mund të jetë ma i ulët se numri i asistentëve i treguar sipas gjuhëve specifike. (3) Sipas informatave të mbledhura nga ekipet komunale të OSBE-së. (4) Takimet e organeve komunale. (5) PTGJ do të thotë personi për kontakt për gjuhë. "P" do të thotë pajisje e instaluar por nuk funksionon ose nuk është përdor. (6) Në praktikë ekziston vetëm një asistent gjuhësor i mbështetur nga dy sekretarësha/daktilografe. R\* UNMIK-u siguron interpretim nëse kërkohet, Burimi: Tabela e përgatitur bazuar në kontributet e ekipeve komunale të UNMIK DCA-së dhe OSBE-së dhënë vlerësimin standard shkurt-prill 2007

**Shtojca III**

**Tabela III: Udhëzimet administrative që duhet aprovuar për të siguruar zbatimin e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve**

Nr.	Dispozita	Ministria përgjegjëse	Tema	Afati nga shpallja e Ligjit për përdorimin e gjuhëve	Udhëzimet administrative (UA) të aprovuara
1.	Neni 10	MALP	UA mbi procedurat për dërgimin e kërkesave lidhur me gjuhët në përdorim zyrtar	(90 ditë) 28/01/2007	UA i MALP-it nr. 2007/6 (07/08/2007) mbi përcaktimin e procedurave për zbatimin e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve që anulon UA-në e MALP-it nr. 2007/02 të 22/01/2007
2.	Nenet 19.4 dhe 36.1	MAPH	Procedurat për të siguruar të mësuarit në gjuhën e zgjedhur zyrtare e cila nuk përdoret nda asnjë shkollë në komunë	(180 ditë) 28/04/2007	UA i MAPH-s-së mbi mësimin në gjuhën e zgjedhur zyrtare (06/04/2007)
3.	Nenet 20.2 dhe 36.1	MAPH	UA mbi Rregullat që i mundësojnë personave gjuha amnore e të cilëve nuk është një gjuhë zyrtare të mësojë në gjuhën e tyre në zonat e populluara nga komuniteti i tyre	(180 ditë) 28/04/2007	Në pritje
4.	Nenet 21.2 dhe 36.1	MAPH	UA mbi procedurat me të cilat personat gjuha e mësimin e të cilëve nuk është një gjuhë zyrtare të mund të deklarohen se në cilën gjuhë duan të	(180 ditë) 28/04/2007	UA e MAPH-s-së nr. 2007/10 mbi Mësimin në gjuhën zyrtare të zgjedhur (06/04/2007)

5.	Nenet 22.2 dhe 36.1	MAPH	studiojnë si gjuhë e dytë Procedura për regjistrimin e strukturave të arsimit privat në gjuhët sipas zgjedhjes personale	(180 ditë) 28/04/2007)	UA e MAPH-së nr. 2003/14 mbi Licencimin e ofruesve privat për shkollimin e lartë në Kosovë (17/07/2003) Mbulon vetëm institutet e larta shkollore
6.	Nenet 24.1 dhe 36.1	MAPH	UA mbi procedurën përmes së cilës një person e deklaron gjuhën zyrtare në të cilën ai ose ajo dëshiron të mbahen shënimet e tija apo saja	(180 ditë) 28/04/ 2007	UA e MAPH-së nr. 2007/10 mbi Mësimin në gjuhën e zgjedhur zyrtare (06/04/2007)
7.	Neni 24.2	MAPH	UA procedurat për lëshuarjen e certifikatave shkollore në gjuhët zyrtare	(90 ditë) 28/01/2007	Në pritje
8.	Neni 32.10	ZKM	UA mbi Kompetencat dhe përbërjen e komisioneve gjuhësore	(90 ditë) 28/01/2007	UA e ZKM-së nr. 2007/3 mbi Përbërjen dhe kompetencat e Komisionit gjuhësor (21/02/2007)
9.	Neni 33	MSHP	UA mbi Dënimet administrative	Nuk është specifikuar	UA e MSHP-së nr. 2007/1 mbi Përcaktimin e dënimeve administrative për shkeljet e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve